Nisma për
Transparencë
në Industrinë
Nxjerrëse

UDHËRRËFYESI EITI

Titulli i origjinalit:
UDHËRRËFYESI EITI

Përkthimi i këtij botimi u realizua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri, me fondet e Nismës për Sigurinë Mjedisore (ENVSEC)

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

www.osce.org/albania

(ENVSEC)

© Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (AlbEITI)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali i përfshirë në këtë botim mund të citohet apo riprintohet lirisht, mjafton që t'i jepen meritat dhe t'i dërgohet një kopje e botimit që përmban materialin e riprintuar Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (AlbEITI).

Projektimi dhe radhitja:

ALBDESIGN

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e AlbEITI-t dhe nuk përfaqëson detyrimisht pozicionin e partnerëve të ENVSEC-ut.

NISMA PËR
TRANSPARENCË
NË INDUSTRINË
NXJERRËSE

UDHËRRËFYESI EITI

TABELA E PËRMBAJTJES

Udhëzim 1:	**Si mund të bëhesh vend kandidat?**
Udhëzimi 2:	**Hartimi i një plani pune për EITI-in**
Udhëzimi 3:	**Regjistrat e lejeve**
Udhëzimi 4:	**Dhënia e licencave**
Udhëzimi 5:	**Raportet e aktivitetit vjetor**
Udhëzimi 6:	**Termat e referencës për një studim fushe për Raportin EITI**
	[viti], [vendi], [data]
Udhëzimi 7:	**Transparenca e kontratave**
Udhëzimi 8:	**Mbikëqyrja e ciklit të raportimit të EITI-it nga Grupi Ndërinstitucional**
Udhëzimi 9:	**Lista e kontrollit që sugjerohet për përcaktimin e fushës së veprimit**
	të Raportimit të EITI-it
Udhëzimi 10:	**Raportimi nënkombëtar**
Udhëzimi 11:	**Adresimi i çështjes së konfidencialitetit të taksapaguesit**
	në raportimin e EITI-it
Udhëzimi 12:	**Raportet Përmbledhëse të EITI-it**

Udhëzimi 1 – 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 1: Si mund të bëhesh vend kandidat?

Udhëzim për proçesin e regjistrimit në EITI .

Regjistrimi në EITI: Hapat për t'u bërë vend kandidat i EITI-it.

Standardi EITI përcakton katër hapa që duhen ndërmarrë për t'u bërë vend kandidat i EITI-it:

- Qeveria duhet të bëjë një deklaratë të qartë publike rreth qëllimit të saj për zbatimin e EITI-it.
- Qeveria duhet të caktojë një person të një niveli të lartë për të drejtuar zbatimin e EITI-it.
- Qeveria duhet të angazhohet në punën me shoqërinë civile dhe kompanitë dhe të ngrejë një Grup Ndërinstitucional për të mbikëqyrur zbatimin e EITI-it.
- Grupi Ndërinstitucional duhet të përgatisë e të përditësojë një plan pune me të gjitha kostot të përcaktuara dhe afatet të përshtatura me afatet e raportimit dhe vlerësimit të vendosura nga Bordi i EITI-it .

Hapat e regjistrimit përshkruhen më hollësisht në Kërkesat 1.1 – 1.4 të Standardit të EITI-it.

Kërkesa për t'u bërë Kandidat në EITI

Kur një vend përmbush hapat e regjistrimit dhe dëshiron që të marrë statusin e vendit kandidat në EITI, qeveria duhet të paraqesë në Bordin e EITI-it një Kërkesë për Vend Kandidat në EITI[1], miratuar nga Grupi Ndërinstitucional. Në kërkesë duhet të përshkruhen aktivitetet e ndërmarra deri në atë kohë dhe të paraqiten provat që tregojnë se është përmbushur secili hap i regjistrimit. Kërkesa duhet të përmbajë detajet e kontaktit për qeverinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat të përfshirë në përgatitjet për zbatimin e EITI-it.

[1] Formulari standard i kërkesës gjendet në Sekretariatin Ndërkombëtar.

Menjëherë pas paraqitjes së saj, kërkesa publikohet në faqen e internetit të EITI-it. Bordi i EITI-it, i cili punon përmes një Komiteti për Komunikimin dhe Kandidaturat, e shqyrton kërkesën dhe vlerëson nëse janë përmbushur hapat e regjistrimit. Sekretariati Ndërkombëtar punon ngushtë me personin e ngarkuar nga qeveria për drejtimin e zbatimit të EITI-it me qëllim sqarimin e çdo çështjeje të pazgjidhur. Bazuar mbi këtë kërkesë dhe mbi çdo informacion tjetër të disponueshëm, Komiteti i Komunikimit dhe Kandidaturave i bën një rekomandim Bordit të EITI-it nëse duhet pranuar apo jo kërkesa e vendit përkatës. Vendimi përfundimtar merret nga Bordi i EITI-it.

Bordi i EITI-it synon t'i shqyrtojë kërkesat brenda 8 javëve nga marrja e tyre. Bordi i EITI-it preferon që ta marrë vendimin për pranimin e kërkesave për statusin e vendit kandidat në EITI në takimet e Bordit të EITI-it, ndonëse, sipas rastit, mund edhe të vendosë në periudhën mes dy takimeve, duke i informuar anëtarët e bordit përmes një letre informuese.

Kur Bordi i EITI pranon një vend si kandidat në EITI, ai përcakton edhe afatet për publikimin e raportit të parë të EITI-it dhe për bërjen e vlerësimit të tij. Raporti i parë i një vendi që zbaton EITI duhet të publikohet brenda 18 muajve nga data kur vendi pranohet vend kandidat në EITI. Vendet kandidate në EITI janë të detyruara që të fillojnë procesin e vlerësimit brenda një periudhe prej dy vjetësh e gjysmë nga momenti i bërjes vend kandidat. Informacione të mëtejshme mbi politikat e afateve gjenden në Kërkesën 1.6 të standardit të EITI-it.

Ku mund të gjej mbështetje?

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it u ofron mbështetje vendeve që mendojnë të zbatojnë EITI-in, duke përfshirë:

- Udhëzime dhe trajnim mbi Standardin e EITI-it dhe kërkesat e regjistrimit.
- Këshillim mbi praktikat e mira nga vende të tjera zbatuese dhe lehtësim të të mësuarit nga vendet homologe, p.sh. në lidhje me termat e referencës së Grupit Ndërinstitucional, ngritjen e sekretariateve kombëtare të EITI-it, hartimin e planeve të punës.

Këshillim mbi mundësitë për asistencë teknike dhe financiare.

Sekretariati Ndërkombëtar nuk ofron mbështetje financiare. Asistenca e drejtpërdrejtë afatmesme tekniko-financiare për mbështetjen e zbatimit nuk drejtohet zakonisht nga Sekretariati Ndërkombëtar, por nga palë të tjera, siç janë Banka Botërore (mbështetur nga Fondi i Besimit të Multi-Donatorëve – MDTF), bankat rajonale të zhvillimit, agjenci të tjera ndërkombëtare zhvillimi, agjenci dypalëshe dhe organizata të shoqërisë civile.

Në varësi të përparësive përkatëse për partneritet dhe bashkëpunim me vendet e EITI-it dhe fushat e interesit të saj, fushat tematike që mund të mbështesin këshilltarët teknikë përfshijnë fushat e mëposhtme ose një pjesë të tyre:

- Nxitja politike;
- Seminare ndërgjegjësuese për EITI-in;
- Ofrimin e mbështetjes teknike për vendet që eksplorojnë angazhimin potencial të EITI-i, p.sh. mbështetje për studimet e fizibilitetit;

- Rrënjosjen e EITI-it si pjesë të një dialogu më të gjerë politikash me vendet ose me palët e interesuara;
- Studimet e fizibilitetit;
- Studime qeveritare për të këshilluar mbi funksionimin dhe menaxhimin e Grupit Ndërinstitucional dhe të Sekretariatit Kombëtar;
- Studimet mbi atë çka mund të mbulojnë sektorët e EITI-it dhe materialiteti i tij.
- Studimet ligjore dhe studimet mbi kufizimet e tjera;
- Seminare prezantimi;
- Vlerësim nevojash të kërkesave financiare dhe teknike.

Udhëzimi 2 – 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it . Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 2: Hartimi i një plani pune për EITI-in

Kërkesa 1.4

Kërkesa 1.4 e Standardit kërkon që Grupi Ndërinstitucional të hartojë e të përditësojë një plan pune, me të gjitha kostot të përcaktuara dhe afatet të përshtatura me afatet e raportimit dhe vlerësimit të EITI-it vendosur nga Bordi i EITI-it. Plani i punës duhet që të përmbushë këto kushte:

a) Të vendosë objektiva për zbatimin e EITI-it që janë në përputhje me Parimet e EITI-it dhe të pasqyrojë përparësitë kombëtare për industritë nxjerrëse. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet që të eksplorojë qasje novatore ndaj shtrirjes së zbatimit të EITI-it, në mënyrë që ajo të rrisë gjithëpërfshirjen e raportimit të EITI-it dhe të kuptuarin nga ana e publikut të të ardhurave, si dhe të nxisë standarde të larta transparence dhe përgjegjshmërie në jetën publike, operacionet qeveritare dhe në biznes;

b) Të pasqyrojë rezultatet e konsultimeve me aktorët e interesuar dhe të ketë miratimin e Grupit Ndërinstitucional;

c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe me afate kohore të përcaktuara për arritjen e objektivave të miratuara. Objekti i zbatimit të EITI-it duhet të përshtatet në mënyrë të tillë që të kontribuojë në rezultatet e dëshiruara dhe në arritjen e ndikimit të identifikuar në procesin e konsultimit. Plani i punës duhet:

   i) të vlerësojë dhe të përcaktojë planet për adresimin e çdo kufizimi të mundshëm të kapaciteteve të agjencive qeveritare, kompanive dhe shoqërisë civile që mund të përbëjnë pengesë për zbatimin efikas të EITI-it;

   ii) të adresojë objektin e raportimit të EITI-it, duke përfshirë planet për adresimin e aspekteve teknike të raportimit, si gjithëpërfshirja dhe besueshmëria e të dhënave (Kërkesat 4 dhe 5); dhe

   iii) të identifikojë dhe të përcaktojë plane për të adresuar çdo pengesë të mundshme ligjore dhe rregullatore për zbatimin e EITI-it , duke përfshirë, nëse ka, çdo plan për t'i përfshirë Kërkesat e EITI-it në legjislacionin ose rregulloret kombëtare.

d) Të identifikojë burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike sipas rastit për të garantuar zbatimin në kohën e duhur të planit të punës të miratuar;

e) Të bëhet gjerësisht i disponueshëm për publikun, për shembull duke u publikuar në faqen e internetit të EITI-it në vend ose/dhe në faqet e ministrive dhe agjencive të tjera përkatëse, në median e shkruar ose në vende ku publiku mund të hyjë lehtësisht;

f) Të rishikohet dhe të përditësohet çdo vit. Gjatë rishikimit të planit të punës, Grupi Ndërinstitucional duhet të mendojë për zgjerimin e objektit dhe përmbajtjes së raportimeve të EITI-it, duke përfshirë adresimin e çështjeve si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (3.7-3.8), pagesat për transportet (4.1.f), shpenzimet sociale diskrecionale (4.1.e), transfertat e posaçme nënkombëtare (4.2.e), pronësia e përfituesve (3.11) dhe kontratat (3.12). në përputhje me Kërkesën 1.3 (g)(viii), Grupi Ndërinstitucional duhet t'i dokumentojë diskutimet dhe vendimet e tij;

g) Të përmbajë një plan kohor për zbatimin që të jetë në përputhje me afatet e raportimit dhe vlerësimit të vendosura nga Bordi i EITI-it (shih pikën 1.6 më poshtë) dhe të marrë parasysh kërkesat administrative si proceset dhe financimet e prokurimit.

Burimi: Standardi EITI, f. 14-15.

Hyrje

Plani i Punës së EITI-it përbën themelin e zbatimit të EITI-it dhe garanton që aktivitetet zbatuese të kenë për qëllim arritjen e rezultateve të dëshiruara nga palët e interesuara. Në bazë të standardit të EITI-it dhe diskutimeve rreth sfidave dhe prioriteteve të industrive nxjerrëse, Grupi Ndërinstitucional, në konsultim me palët e interesuar kryesorë, duhet të hartojnë një plan pune që përcakton pse po zbatohet EITI dhe çfarë çështjesh do të përpiqet që të adresojë procesi i EITI-it. EITI është relevant në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme. Ai zbatohet për të adresuar shqetësime specifike si korrupsioni, mungesa e besimit, apo për të tërhequr investimet e huaja direkte.

Fazat kryesore për krijimin e një plani pune janë:

- Identifikimi i objektivave të politikave që lidhen me administrimin e burimeve natyrore.
- Përkufizimi i aktiviteteve zbatuese që pritet të përmbushin objektivat dhe cilat prej tyre janë të përshtatshme për zbatim nga organet e EITI-it dhe cilat nga institucione të tjera. Për ato që duhet të ndërmerren nga organet e EITI-it.
    - Analizoni kontekstin specifik dhe risqet politike;
    - Identifikoni boshllëqet në kapacitete (dhe nevojat për asistencë);
    - Identifikoni partnerët për bashkëpunim;
    - Identifikoni burimet e financimit; dhe
    - Bëjeni planin tuaj të punës publik.
- Përgatitja e mekanizmit të monitorimit
    - Identifikimi i treguesve të objektivave në planin e punës dhe krijimi i një kuadri për monitorimin sistematik të progresit drejt rezultateve dhe ndikimit të dëshiruar (kjo lidhet ngushtë me kërkesën 7.2 për raportimin vjetor të aktiviteteve; shih kapitullin 5 për Monitorimin më poshtë).
- Rishikimi sistematik i planit të punës dhe treguesve.

Këto faza paraqiten në figurën 1 dhe shpjegohen më poshtë:

Figura 1: Hapat për krijimin e një plani pune

1. Identifikimi i Objektivave
2. Planifikimi i aktiviteteve që përmbushin objektivat
3. Monitorimi
4. Rishikimi

1. Identifikimi i objektivave për zbatimin e EITI-it.

Diskutimet për planin e punës zakonisht fillojnë me përfaqësues të Grupit Ndërinstitucional në konsultim me palët e interesuara të EITI-it në lidhje me pikëpamjet e tyre mbi prioritetet për menaxhimin e sektorit nxjerrës dhe se si mund të arrihen sa më mirë këto rezultate. Grupi Ndërinstitucional duhet të dalë me një vizion të përbashkët strategjik mbi objektivat që EITI dëshirohet të kontribuojë në vend. Është e rëndësishme që procesi i konsultimit me aktorët e interesuar të jetë i gjerë, të përfshijë qeverinë, kompanitë nxjerrëse dhe

shoqatat e industrisë , si dhe të marrë parasysh edhe kontributin e shoqërisë civile, e cila mund të hasë pengesa dhe kufizime që ndikojnë në angazhimin e saj në EITI. Grupi Ndërinstitucional mund të shohë mundësinë e organizimit të një ose më shumë tryezave pune për të mbledhur opinionet e aktorëve të interesuar.

Duke pasur parasysh burimet e kufizuara. Grupi Ndërinstitucional mund të duhet të përcaktojë objektivat prioritare dhe të përqendrohet tek ato që mund të arrihen nga EITI. Mund të ndodhë që për arsye politike, praktike apo thjesht për arsye që lidhen me burimet, disa aktivitete të përmbushen më mirë nga institucione të tjera.

Disa pyetje që ndihmojnë për të identifikuar objektivat e zbatimit:

- Kur do ta konsideronin pjesëmarrësit EITI-in si të suksesshëm? Çfarë presin pjesëmarrësit nga zbatimi i EITI-it? Çfarë aktivitetesh do të kontribuonin në realizimin e Parimeve të EITI-it ?
- Çfarë nevojitet për ta transformuar transparencën në pritshmëritë e shprehura?
- A janë pjesëmarrësit në gjendje që të tregojnë rrugën që çon që nga krijimi i Grupit Ndërinstitucional deri te pritshmëritë e tyre?
- Duke parë burimet që keni në dispozicion, sa objektiva mundet që të realizojë vërtetë EITI ?
- Cili është objektivi më i ngutshëm që EITI mund të arrijë?
- Cili është objektivi më i ngutshëm, në të cilin mund të kontribuojë EITI?

2. Përkufizoni aktivitetet për zbatimin e EITI-it që pritet të çojnë në përmbushjen e objektivave.

Grupi Ndërinstitucional do të duhet që të organizojë disa aktivitete për të përmbushur objektivat e cilësuara si prioritet. Këtu duhet të merren parasysh ato pjesë të Standardit të EITI-it që janë të detyrueshme dhe ato që inkurajohen për t'u arritur, si për shembull transparenca e kontratave dhe pronësia e përfituesit. Nëse Grupi Ndërinstitucional vendos që të bashkëpunojë me organizata të tjera apo që ta ngulisë procesin e zbatimit në një proces më të gjerë reformash kombëtare, mund të jetë e dobishme që në planin e punës të identifikohen lidhjet specifike. Përveç kësaj, plani i punës duhet të përmbajë një vlerësim të kufizimeve të kapacitetit (nevojat korresponduese për asistencë), si dhe datat dhe afatet kryesore të zbatimit. Më pas, ky plan pune, duhet të shoqërohet me përcaktimin e plotë dhe realist të kostove. Grupi Ndërinstitucional duhet të diskutojë dhe të shqyrtojë burimet e financimit.

Grupi Ndërinstitucional mund ta gjykojë të dobishme edhe që të organizojë një pjesë ose të gjithë planin e punës në një format më vizual, si për shembull në formën e një tabele ose diagrame, siç tregohet në tabelën 1.

Tabela 1: Struktura e propozuar e planit të punës

Objektivat prioritare (të shpjeguara)	Konteksti: Parakushtet dhe rreziqet	Kufizimet e kapacitetit	Aktivitetet	Partnerët bashkë-punues dhe lidhjet me proce-set e tjera të refor-mave	Afati	Kostoja dhe financimi

Sapo ta ketë bërë këtë, Grupi Ndërinstitucional duhet të jetë në gjendje që të identifikojë gamën e informacioneve që duhet të përfshihen në raportet e EITI-it dhe në raporte plotësuese, si lidhet kjo me kërkesat e EITI-it, si të garantohet gjithëpërfshirja dhe besueshmëria e të dhënave, si të nxitet debati publik dhe aktivitetet që kërkohen për arritjen e rezultateve. Komunikimi shihet si një nga mjetet kryesore të Grupi Ndërinstitucional për të punuar për arritjen e objektivave të tyre. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara, Grupi Ndërinstitucional mund të shqyrtojë mundësinë e aktiviteteve të komunikimit më grupe specifike, që lidhen me arritjen e objektivave me prioritet. (Grupi Ndërinstitucional mund të shohë mundësinë e marrjes së më shumë ideve për strategjitë e komunikimit nga publikimi i EITI-it "Talking Matters").

Grupi Ndërinstitucional është e inkurajuar që ta bëjë publikisht të njohur versionin paraprak të planit të punës, si për shembull përmes publikimeve në faqen kombëtare të internetit të EITI-it dhe/ose në faqet e ministrive dhe agjencive të tjera përkatëse, në median e shkruar ose në vende ku publiku mund të hyjë lehtësisht. Kështu, aktorëve të interesuar u jepet kohë e mjaftueshme për ta rishikuar versionin paraprak të planit të punës me qëllim që të vlerësojnë përmbajtjen dhe zbatueshmërinë e tij për sa i përket si kontekstit lokal, ashtu edhe kërkesave të EITI-it. Angazhimet për financim duhet të konfirmohen në përputhje me planin përfundimtar të punës, miratuar nga Grupi Ndërinstitucional.

Disa pyetje që ndihmojnë për të përcaktuar aktivitetet e zbatimit të EITI-it që pritet të çojnë në përmbushjen e objektivave të tij:

- A ekziston një mirëkuptim mes të gjitha palëve sa u përket objektivave me prioritet, si për shembull "përgjegjshmërisë"?
- Cilat janë kufizimet aktuale politike dhe të kapacitetit?
- A janë aktivitetet vërtetë në shërbim të objektivave me prioritet?
- A besojnë pjesëmarrësit se objektivat me prioritet janë të arritshme duke pasur parasysh parakushtet e nevojshme dhe kapacitetet e partnerëve bashkëpunues?
- A po zhvillohen aktualisht procese reformash në fushën e administrimit të burimeve dhe financave publike ku EITI mund të kontribuonte?
- A janë afatet realiste?
- Sa para duhen për ta zbatuar planin e punës dhe nga mund të vijnë fondet për aktivitetet e parashikuara?

3. Monitorimi

Ngritja dhe përdorimi i një sistemi monitorimi janë të lidhura ngushtë me detyrimin e raportimit të përvitshëm, i cili ka objektiva të përcaktuara në planin e punës (Kërkesa 7.2.iv)

Grupi Ndërinstitucional mund të shohë mundësinë e ngritjes së sistemit të monitorimit duke përdorur tregues të matshëm për të përcaktuar ecurinë prej objektivave parësorë të përcaktuar në planin e punës. Grupi Ndërinstitucional mund ta shohë si të dobishme organizimin e treguesve dhe monitorimin e tyre siç tregohet në tabelën 2:

Tabela 2: Strukturë model e një mekanizmi monitorimi

Objektivat sipas për-parësisë	Treguesit	Burimet e të dhënave	Sa shpesh mblidhen të dhënat	Përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave	Situata fillestare	Ecuria drejt objekti-vave

Raporti i përvitshëm i aktiviteteve duhet të bëhet publik (Kërkesa 7.2). Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë që të bëjë publik edhe çdo rezultat shtesë për monitorimin për të informuar publikun e interesuar rreth progresit të arritur.

Disa pyetje që ndihmojnë për monitorimin:

- Çfarë të dhënash ka në dispozicion Grupi Ndërinstitucional?
- Cila organizatë mund të ndihmojë për mbledhjen e të dhënave (p.sh. Universitetet, OJQ-ë, Komisionet e Anti-Korrupsionit)?
- Sa dhe cilët tregues dëshirojnë pjesëmarrësit që të raportojnë në vlerësimin e tyre të përvitshëm?

4. Rishikimi

Kushtet e vendit në të cilat zbatohet EITI janë objekt ndryshimesh të vazhdueshme. Bazuar në rezultatet e monitorimin dhe në dritën e objektivave të politikave që ndryshojnë vazhdimisht, plani i punës duhet të rishikohet dhe të përditësohet çdo vit (Kërkesa 1.4.f). Grupet Ndërinstitucionale inkurajohen që t'i rafinojnë e t'i përmirësojnë vazhdimisht planet e tyre të punës.

Disa pyetje që ndihmojnë për rishikimin:

- A ka një grup brenda Grupit Ndërinstitucional të ngarkuar me ndjekjen e monitorimit?
- A ka ndryshuar konteksti në të cilin zbatohet EITI?
- A rishikohen sistematikisht vizioni i suksesit dhe plani i punës?
- A janë rezultatet e monitorimit të aksesueshme për publikun e gjerë?

Udhëzimi 3 – 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 3: Regjistrat e lejeve

Kërkesa 3.9

Përmbledhje

Shumica e vendeve të pasura me burime kanë regjistra të dhënash që i ndihmojnë ata që të menaxhojnë sistemet e lejeve të industrisë. Publikimi i regjistrave të lejeve dhe informacioneve që lidhen, e të drejtat e nxjerrjes u japin mundësi qytetarëve që të shohin se cilave kompani u janë dhënë të drejtat për të shfrytëzuar burimet e tyre natyrore. Mbajtja e një sistemi regjistrash të saktë është thelbësore edhe për të nxitur investimet, për të optimizuar kontributin e sektorit në vend, si dhe për të qartësuar të drejtat e pronësisë, si dhe për të shmangur konfliktet e pronësisë dhe vendndodhjen e banesave me qira.

EITI kërkon që vendet që e zbatojnë atë të mbajnë një regjistër të përditësuar dhe të plotë të lejeve (Kërkesa 3.9). Kërkesa 3.9(b) përshkruan të gjitha informacionet që duhet të përmbajë ky regjistër. Kërkesa 3.9(c) thekson se "kur ky informacion është bërë ndërkohë publik, mjafton që në Raportin e EITI-it të vendoset një referencë ose adresa e faqes së internetit ku mund të gjendet". Kriteret përshkruhen me hollësi si më poshtë. Ky udhëzim orienton Grupet Ndërinstitucionale për mënyrat se si duhet t'i adresojnë këto çështje si pjesë të procesit të zbatimit të EITI-it.

Disa vende që zbatojnë EITI-in, si Mongolia dhe Togo, i publikojnë të gjitha lejet e industrive nxjerrëse në raportet e tyre të EITI-it. Në shumë vende që e zbatojnë këtë nismë, ky informacion mund të merret nga agjencitë qeveritare dhe në bazat online të të dhënave. Këto baza të dhënash variojnë që nga tabelat e thjeshta në programin Excel deri te sistemet e sofistikuara online, ku përfshihen edhe ndërfaqet GIS për gjetjen e koordinatave të ndërtesave të marra me qira, të dhënat gjeologjike dhe informacione të tjera sa i përket sistemit të dhënies së lejeve.

Kërkesa 3.9. përshkruan kriteret që duhet të plotësojnë regjistrat e lejeve:

3.9 Regjistri i lejeve

a) Termi 'leje' në këtë kontekst nënkupton çdo licencë, marrje me qira, titull, leje apo koncesion përmes të cilit qeveria i jep një ose disa kompanive ose një ose disa individëve të drejta për kërkimin apo shfrytëzimin e naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare.

b) Vendet që zbatojnë nismën duhet të mbajnë një regjistër publik ose një ose disa sisteme kadastrash që përmbajnë informacionet e mëposhtme gjithëpërfshirëse dhe kohore në lidhje me çdo leje që u përket kompanive të përmendura në raportin e EITI-it:

   i. Mbajtësi(t) i lejes;
   i. Koordinatat e zonës për të cilën është dhënë leja;
   ii. Datën e kërkesës për leje, datën në të cilën është dhënë leja dhe periudhën për të cilën është e vlefshme leja;
   iii. Në rastin e lejeve për prodhim, duhet të përcaktohet edhe produkti që prodhohet.

Regjistrat ose kadastrat e lejeve pritet që të përmbajnë informacione rreth lejeve të të gjitha objekteve, duke përfshirë edhe kompanitë dhe individët ose grupet që nuk përfshihen në Raportin e EITI-it, domethënë në rastet kur pagesat që ata bëjnë qëndrojnë shumë më poshtë sesa kufiri i miratuar i materialitetit. Në rastet kur ka pengesa të konsiderueshme ligjore apo praktike që pengojnë dhënien e informacioneve kaq të plota, kjo duhet të dokumentohet dhe të shpjegohet në Raportin e EITI-it, duke përfshirë edhe një përshkrim të planeve të qeverisë për kapërcimin e këtyre pengesave dhe një afat të parashikuar për ta arritur këtë.

c) Në rastet kur informacioni i përshkruar në 3.9(b) më sipër është publikuar, mjafton që në Raportin e EITI-it të vendoset një referencë ose adresa e faqes së internetit ku mund të gjendet. Në rastet kur këta regjistra apo këto kadastra nuk ekzistojnë ose janë të paplota, Raporti i EITI-it - duhet të bëjë të ditur çdo boshllëk në informacionet e publikuara dhe të dokumentojë përpjekjet që bëhen për forcimin e këtyre sistemeve. Ndërkohë, vetë Raporti i EITI-it duhet të përmbajë informacionet e përshkruara në pikën 3.9(b) më sipër.

Burimi: Standardi EITI, f. 23

Udhëzim

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it u rekomandon Grupeve Ndërinstitucionale këtë qasje hap-pas-hapi për adresimin e Kërkesës 3.9:

1. **Të kuptuarit e sistemit të lejeve**. Sipas Kërkesës 3.9(b), vendet që zbatojnë këtë nismë duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem kadastrial. Grupi Ndërinstitucional këshillohet që ta plotësojë këtë kusht duke parë dhe duke kuptuar mirë në fillim informacionin ekzistues në lidhje me sistemin e dhënies së lejeve.

Disa pyetje orientuese:

- A trajtohen në Kushtetutë të drejtat për naftën, gazin dhe mineralet, duke ua dhënë pronësinë e burimeve natyrore kombit dhe popullit të tij, dhe/ose në legjislacionin specifik të sektorit përkatës?
- Cilat agjenci kanë autoritetin për të dhënë të drejtat ose lejet për hidrokarburet dhe mineralet?
- A janë të përfshira këto agjenci aktualisht në procesin e EITI-it ?
- A ekziston një regjistër/sistem kadastrial publik?
- (Shënim: Mund të ketë më shumë se një sistem, p.sh. sisteme kombëtare, rajonale dhe lokale, dhe në qoftë se është kështu, a ka një ndarje të qartë të kompetencave midis tyre dhe si zgjidhen zakonisht mosmarrëveshjet)
- Sa shpesh përditësohet(n) regjistri (regjistrat) dhe kush e kryen këtë punë?
- A po ndërmerret ndonjë reformë për sistemin ekzistues të dhënies së lejeve?

2. Vlerësimi i plotësisë së informacionit në lidhje me lejet. Pritet që regjistri apo kadastra të përmbajnë informacione rreth të gjitha lejeve që jepen në sektorin e industrisë nxjerrëse (Kërkesa 3.9(b)). Në rastet kur ka pengesa të konsiderueshme ligjore apo praktike që nuk lejojnë një publikim të plotë, kjo duhet të dokumentohet dhe të shpjegohet në Raportin e EITI-it, duke përfshirë edhe një përshkrim të planeve të qeverisë për kapërcimin e këtyre pengesave dhe afatin e parashikuar për ta arritur këtë (Kërkesa 3.9 (b)). Prandaj, Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të analizojë nëse informacioni ekzistues është i plotë, duke vlerësuar për shembull:

    c) A është regjistri i lejeve i plotë dhe i përditësuar, domethënë. A i mbulon të gjitha lejet e dhëna për industrinë nxjerrëse? Nëse jo:

        - A janë të gjitha lejet e kompanive në Raportin EITI? Nëse jo, sa përqind e tyre janë në regjistër?
        - Çfarë pengesash ligjore dhe praktike ekzistojnë që pengojnë bërjen publike të informacioneve rreth të gjitha lejeve të industrisë nxjerrëse, nëse ka të tilla?
        - Çfarë lloje sistemesh ekzistojnë aktualisht, domethënë manuale apo kompjuterike?

- A është sistemi i përditësuar, domethënë sa saktë e pasqyron ai pronësinë aktuale të lejeve? A ka ndonjë mënyrë për të parë ndryshimet që bëhen në pronësinë e lejeve të paregjistruara në regjistër?
- A po zhvillohet ndonjë reformë për të adresuar mangësitë në kadastrën e lejeve dhe, nëse po, cilët janë afatet e parashikuara ?

d) Regjistri i lejeve përmban informacionin e nevojshëm sipas Kërkesës 3.9(b):

- Kush janë zotëruesit e lejeve?
- Cilat janë koordinatat e zonës për të cilën është dhënë leja?
- Sa është kohëzgjatja e lejes (data kur është kërkuar leja, data e dhënies së lejes dhe kohëzgjatja e lejes)?
- Në rastin e lejeve të prodhimit, çfarë produkti prodhohet?

3. **Të garantohet që informacioni të jetë i disponueshëm për publikun.** Në bazë të analizës së mësipërme, Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të bjerë dakord për mënyrën se si do ta përfshijë këtë informacion në Raportin EITI. Kërkesa 3.9(c) thekson se "aty ku informacioni i përshkruar në pikën 3.9(b) më sipër është bërë publik, mjafton që në Raportin EITI të vendoset një referencë ose adresa e faqes së internetit ku ai mund të gjendet. Aty ku këta regjistra apo këto kadastra nuk ekzistojnë ose nuk janë të plotë, Raporti EITI duhet të bëjë të ditur çdo boshllëk në informacionin e bërë publik dhe të dokumentojë përpjekjet për forcimin e këtyre sistemeve. Ndërkohë, vetë Raporti EITI duhet të përmbajë informacionin e përshkruar në pikën 3.9(b) më sipër". Prandaj, Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të marrë parasysh:

- Përfshirjen e një përmbledhjeje të shkurtër të vlerësimit të mësipërm në Raportin EITI, duke përfshirë një përmbledhje të aktivitetit të licencuar në periudhën e mbuluar nga Raporti EITI.
- Aty ku informacioni mbi lejen është i kohës së duhur, i plotë dhe i bërë publik, në Raportin EITI të vendoset adresa e faqes së internetit të regjistrit të lejeve.
- Aty ku ka dobësi në informacionin e bërë publik, mund të vendosë një tabelë në Raportin EITI ose në faqen e internetit të EITI-it me informacionin e nevojshëm.

Shënim: Zakonisht, nëse një vend ka një sistem të paplotë apo të pasaktë, Grupi Ndërinstitucional nuk mund të shkojë përtej rolit të tij e të kthehet në një regjistër të autorizuara lejesh. Grupi Ndërinstitucional mund të shohë se si mund të evidentojë boshllëqet ose mangësitë në sistemet e vendit të vet për dhënien e lejeve dhe të inkurajojë zgjidhje praktike dhe afatgjata për një përditësim të saktë të informacionit të publikuar në lidhje me lejet.

3. Shembuj

Regjistri i Naftës së Norvegjisë mbahet nga Drejtoria e Naftës së Norvegjisë. Të dhënat regjistrohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e naftës dhe një kopje e tyre vendoset përditë në online FactPages.

⊟ General information

Production licence	001
NPDID production licence	20756
Fact map	link
Status	ACTIVE
Main area	North sea
Licensing activity	1-A
Date granted	01.09.1965
Date valid to	01.03.2030
Original area [km2]	2145.855
Current area [km2]	100.779

⊟ Phases

Date phase valid from	Date phase valid to	Phase
01.09.1965	31.08.1971	INITIAL
01.09.1971	31.08.2011	PRODUCTION
01.09.2011	01.03.2030	PRODUCTION EXTENDED

⊟ Licensees - current

Date valid from	Company longname	Interest [%]
01.10.2004	ExxonMobil Exploration & Production Norway AS	100.00000

Burimi: Drejtoria Norvegjeze e Naftës, http://factpages.npd.no/factpages/default.aspx

Ministria e Energjisë dhe Minierave të Tanzanisë, së bashku me Dimensionin Hapësinor, po zhvillojnë një kadastër online.



Burimi: Ministria e Energjisë dhe Minierave e Tanzanisë dhe Dimensioni Hapësinor Pty Ltd-SD, http://www.flexicadastre.com/tanzania

Në Raportin EITI për vitin 2011, Togo përfshiu edhe një pasqyrë të të gjitha lejeve të zotëruara nga kompanitë e mbuluara në Raportin EITI, duke përfshirë informacione si produktet e kërkuara dhe/ose prodhuara, numrat e referencës së lejeve dhe kohëzgjatjen e lejeve.

Societe	Substance principale	Type du permis	Référence du titre	Date d'octroi	Durée (années)	Superficie (en km2)	Localité
SNPT	Phosphate	Exploitation à grande échelle	97-068/PR	29/04/1997	20	24.42	Hahotoe (Vo)
	Phosphate	Exploitation à grande échelle	97-068/PR	29/04/1997	20	15.46	Kpogamé (Zio)
WACEM	Calcaire	Exploitation à grande échelle	96-167/PR	30/12/1996	20	20	Tabligbo (Yoto)
	Calcaire	Exploitation à grande échelle	2006-177/PR	12/06/2006	20	5.5	Tabligbo (Yoto)
MM Mining(*)	Fer	Exploitation à grande échelle	2008-021/PR	13/02/2008	20	NC	Bassar (Bassar)
Scantogo Mines	Calcaire	Exploitation à grande échelle	2009-175/PR	12/08/2009	20	14.1	Tabligbo (Yoto)
POMAR	Marbre	Exploitation à grande échelle	2010-144/PR	24/11/2010	20	12.4	Bitta
	Phosphate	Recherche	013/08/MMEE/DGMG/DRGM	02/04/2008	3	184.19	Bassar (Bassar)
	Phosphate	Recherche	013/08/MMEE/DGMG/DRGM	02/04/2008	3	186.52	Bassar (Bassar)
	Phosphate	Recherche	014/08/MMEE/DGMG/DRGM	02/04/2008	3	162.09	Bassar (Bassar)

Burimi: Raporti EITI i Togos për vitin 2011, http://www.itietogo.org/

Udhëzimi 4 - 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 4: Dhënia e licencave

Kërkesa 3.10

Përmbledhje

Shumica e vendeve të pasura me burime kanë krijuar sisteme për dhënien e licencave për eksplorim dhe shfrytëzim të naftës, gazit dhe mineraleve. Në shumicën e vendeve, procedurat për tenderimin dhe dhënien e licencave përcaktohen me legjislacion dhe rregullore, të cilat përmbajnë mënyrën se si dhe mbi çfarë bazash u jepen të drejtat këtyre kompanive. Në vende të tjera, këto procedura janë *ad hoc*, në proces shqyrtimi, ose nuk janë të artikuluara qartë. Informimi mbi sistemet e licencimit i ndihmon qytetarët të kenë informacion të rëndësishëm mbi mënyrën e zhvillimit të burimeve natyrore të vendit të tyre. Ky është gjithashtu një hap i parë që siguron se licencat nuk merren përmes praktikave jo efikase apo të korruptuara dhe as përmes njohjeve politike. Në rast se nga informacioni i dhënë identifikohen mangësi në sistemin e licencimit, palët mund ta përdorin këtë informacion për të ushtruar presion për reforma që sigurojnë sisteme më transparente dhe efikase të dhënies së licencave. Kjo do të sillte zhvillim të klimës së investimeve dhe potencialit për zhvillim të industrive nxjerrëse.

EITI kërkon që vendet zbatuese të japin informacion mbi dhënien dhe transferimin e licencave kompanive të përfshira në Raportin e EITI-it (Kërkesa 3.10). Ky informacion duhet të përmbajë përshkrimin e procesit të dhënies së licencave, kriteret e përdorura, shmangiet nga kuadri ligjor, si dhe politikat mbi licencimin (Kërkesa 3.10a). Shtetet mund të përfshijnë edhe informacion shtesë mbi procesin e licencimit, si për shembull një përshkrim mbi efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre sistemeve (Kërkesa 3.10d). Në disa vende zbatuese, informacioni mbi dhënien e licencave mund të gjendet në faqet e internetit të qeverisë. Në vende të tjera, mund të gjendet shumë pak informacion mbi mënyrën dhe kushtet e licencimit të kompanive. Ky udhëzim drejton Grupet Ndërinstitucionale si t'i adresojnë këto çështje si pjesë e procesit të zbatimit të EITI-it. Ky informacion duhet të lexohet paralelisht me udhëzuesin mbi regjistrat e licencave[2].

[2] http://eiti.org/files/Guidance%20note%203%20-%20License%20Registers_FINAL_20131113.pdf

Kërkesa 3.10 përcakton kriteret raportuese mbi dhënien e licencave:

3.10 Dhënia e licencave

a) Vendeve zbatuese u kërkohet të japin informacion mbi dhënien apo transferimin e licencave që i përkasin kompanive të përfshira në Raportin e EITI-it, duke përfshirë: përshkrim të procesit të transferimit apo dhënies së licencës; kriteret teknike dhe financiare; informacion mbi marrësin(it) e licencës së transferuar apo të dhënë, duke përfshirë, sipas rastit, edhe anëtarët e konsorciumeve; çdo shmangie jo të parëndësishme nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi mbi transferimin dhe dhënien e licencave.

b) Në rastin kur licencat jepen përmes një tenderi gjatë periudhës së raportimit të mbuluar nga Raporti i EITI-it, qeveria duhet të publikojë listën e aplikuesve dhe kriteret e tenderit.

c) Kur informacioni i nevojshëm, i përcaktuar në Kriterin 3.10(a) dhe 3.10(b) më sipër, është publik, mjafton të përfshihet një referencë apo *link* i Raportit të EITI-it .

d) Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të përfshijë informacion shtesë mbi dhënien e licencave në Raportin e EITI-it , duke përfshirë edhe një përshkrim mbi efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre sistemeve.

Burimi: *Standardi* EITI*f. 24*

Udhëzim

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it u rekomandon Grupeve Ndërinstitucionale përqasjen e mëposhtme hap pas hapi për të adresuar këtë kriter:

1. **Për të siguruar që Raporti i EITI-it të përfshijë një përshkrim të procesit të transferimit apo dhënies së licencave (Kërkesa 3.10(a)), Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të mësojë se si jepen licencat, për shembull duke shqyrtuar sa më poshtë vijon:**

   - A përcaktohen me ligj dhe rregullore procedurat e aplikimit për licencë dhe procesi i dhënies dhe miratimit të licencave?
   - Çfarë praktikash licencimi përdor zakonisht qeveria? Proces tenderimi, ankande, negociata të drejtpërdrejta, apo parimin 'fiton kush aplikon i pari'? Shënim: proceset [e licencimit] për minierat, naftën dhe gazin mund të jenë të ndryshme dhe mund të duhet të paraqiten të ndara.
   - Cili apo cilët institucione kanë autoritetin për të dhënë licenca për naftë, gaz dhe minerale?
   - A merren vendimet për të dhënë leje në bazë të kritereve/parametrave të

mirëkrijuara, të qëndrueshme dhe të qarta, dhe a publikohen për çdo licencë? Këtu mund të përfshihen kualifikimet teknike dhe financiare të nevojshme për të pasur një të drejtë për naftë, gaz apo minerale, kushtet ligjore, shëndetësore, të sigurisë dhe mjedisit, programet e punës, etj.

- A po kryhet ndonjë reformë në lidhje me sistemet ekzistuese të dhënies së licencave?
- A sigurojnë procedurat e licencimit të drejtë pasuese, midis të drejtës për eksplorim dhe zhvillim, në rastin kur zbulohet naftë, gaz apo minerale?

2. **Sipas Kërkesës 3.10(a), informacioni mbi dhënien apo transferimin e licencave kompanive të përfshira në Raportin e EITI-it duhet bërë publik. Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të informohet nëse janë dhënë licenca apo janë bërë transferime, dhe të përfshijë një përmbledhje të këtyre proceseve në Raportin e EITI-it. Përmbledhja duhet të përfshijë (Kërkesa 3.10(a)):**

- Përshkrim i procesit të dhënies apo transferimit të licencës. Nëse ky informacion është publik, mjafton të përfshihet një *link* apo referencë e burimit ku mund të gjendet informacioni.
- Detaje të kushteve teknike dhe financiare për dhënien apo transferimin e licencës(ave). Nëse ky informacion është publik, mjafton të përfshihet një *link* apo referencë e burimit ku mund të gjendet informacioni.
- Informacion mbi përfituesin(it) e licencës(ave). Kjo mund të bëhet, për shembull, duke përfshirë një *link* apo referencë të një regjistri publik apo sistemi kadastre që përmban informacionin. Në rast se regjistrat/kadastrat nuk e përmbajnë informacionin e nevojshëm, Grupet Ndërinstitucionale duhet të sigurohen që ky informacion të bëhet publik – për shembull duke i bashkëngjitur detajet Raportit të EITI-it ose duke e publikuar në faqen kombëtare të internetit të EITI-it . Për sa i përket Kërkesës 3.9(b), informacioni mbi përfituesin(it) duhet të përfshijë:
    - Mbajtësin(it) e licencës, duke përfshirë edhe anëtarët e konsorciumeve, sipas rastit;
    - Koordinatat e zonës që mbulon licenca;
    - Kohëzgjatjen e licencës (datën e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatjen e licencës); dhe
    - Në rast licence për prodhim – llojin e artikullit të prodhuar.
- Një vlerësim që tregon nëse procesi i dhënies apo transferimit të licencës(ave) është kryer sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Çdo shmangie e rëndësishme – si për shembull rastet kur licenca është dhënë përmes një praktike të ndryshme licencimi nga ajo e zakonshmja; devijimet nga kriteret standarde, duke përfshirë kushtet e kontratës, etj.

3. **Sipas Kërkesës 3.1(b), Grupi Ndërinstitucional duhet të konstatojë nëse është dhënë ndonjë licencë përmes një procesi tenderimi gjatë periudhës së raportimit të mbuluar nga Raporti i EITI-it.** Në rast se po, Raporti i EITI-it duhet të përfshijë apo të japë *link*-un që tregon:
   - Listën e aplikuesve; dhe
   - Detaje në lidhje me kriteret e tenderit.
4. **Grupi Ndërinstitucional mund të dojë të përfshijë informacion shtesë mbi dhënien e licencave në Raportin e EITI-it (Kërkesa 3.10(d). Për shembull, Grupi Ndërinstitucional mund të shqyrtojë dhe të përfshijë:**
   - Një shpjegim mbi efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre sistemeve. Kjo mund të përfshijë:
     - Kohëzgjatjen e procesit të licencimit, duke përfshirë edhe devijimet nga afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor apo në udhëzime;
     - Përqindjen e aplikimeve për licenca të refuzuara gjatë vitit financiar të mbuluar nga Raporti i EITI-it;
     - Përqindjen e tenderave bosh apo ankandeve të anuluara gjatë vitit financiar të mbuluar nga Raporti i EITI-it;
     - Përqindjen e tokës/blloqeve të zotëruara si përqindje e tokës/blloqeve totale të hapura për aktivitetin e industrisë nxjerrëse; dhe
     - Përqindjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me procedurat e aplikimeve apo të tenderimit gjatë vitit financiar të mbuluar nga Raporti i EITI-it, si dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.
   - Informacion për numrin e licencave të hequra/anuluara gjatë vitit raportues të mbuluar nga Raporti i EITI-it, duke përfshirë edhe arsyet e anulimit.
   - Informacion mbi ndryshimet në lidhje me pronësinë e zotëruesve të licencave gjatë vitit raportues të mbuluar nga Raporti i EITI-it.
   - Disponueshmëria e përgjithshme e informacionit mbi dhënien e licencave dhe sa lehtë mund të gjendet ky informacion, sa i besueshëm është dhe sa ruhet fshehtësia e të dhënave.

Shembuj

Në **Liberi**, LEITI ka kryer një auditim të plotë të proceseve të dhënies së koncesioneve, kontratave, licencave, lejeve – pasi janë dhënë - dhe të drejtave të tjera për të shfrytëzuar burimet natyrore gjatë periudhës korrik 2009 – dhjetor 2011. Auditi kishte për qëllim të vërtetonte nëse proceset e licencimit ishin kryer në përputhje me ligjet e Liberisë që kanë qenë në fuqi në atë periudhë. Raporti i auditit mund të gjendet në:

http://www.INTIN.org.lr/uploads/2/1/5/6/21569928/INTIN_post_award_process_audit_final_report.pdf

Raporti i EITI-it për **Mongolinë** përfshin një përmbledhje të ndryshimeve të licencave të kompanive të përfshira në Raportin e EITI-it.

Shtojca K – Pyetësor mbi licencat për eksplorim dhe shfrytëzim

#	Emri i kompanisë	Numri i licencave për shfrytëzim				Numri i licencave për eksplorim				Komente
		Balanca fillestare për vitin 2010	Të blera	Të zbritura	Balanca përfundimtare për vitin 2010	Balanca fillestare për vitin 2010	Të blera	Të zbritura	Balanca përfundimtare për vitin 2010	
1	Agit Khangai LLC	1			1	1			1	
2	Agm Mining LLC	1			1	2		8	2	
3	Adamas Mining LLC	1		1	0	16		10	8	Një u kthye pjesërisht; të tjerat kishin përfunduar dhe ishin anuluar
4	Adamas Mounty LLC	1			0	15		1	5	Të përfunduara dhe anuluara
5	Adil Och LLC	1			1	1			0	Të anuluara

Burimi: Raporti i EITI-it për Mongolinë 2010, i cili gjendet në:

http://NTIN.org/report/mongolia/2010

Në **Norvegji**, informacioni mbi procedurat e licencimit është i publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë Norvegjeze të Petroleum.

Linqe të përshtatshme:



Relevant links:

- Invitation to apply for petroleum production license (pdf)
- Ministry of Petroleum and Energy

Guidelines:

- Guidelines for applying to the 22nd licensing round (pdf)
- Guidelines for reporting company information (pdf)
- Guidelines for application letter (pdf)

Forms that must be filled out:

- Application letter table (MS Excel)
- Form 1 (MS Excel)
- Form 2 (MS Excel)
- Form 3 (MS Excel)
- Form 4 (MS Exel) *Updatet 23.10.2012*
- Form 5 (MS Exel)
- Form 6 (MS Exel)
- Form 7 (MS Exel)
- Form 8 (MS Exel)

Other application information:

- Form 4 attachment(MS Excel)
- Map of announced blocks 22. Licensing Round (pdf)
- Block coordinates for announced blocks

Burimi: Drejtoria Norvegjeze e Petroleum

http://www.npd.no/en/Topics/Production-licences/Theme-articles/Licensing-rounds/22-nd-Licencing-round/22st-licensing-round-announcement/

Në **Trinidad dhe Tobago**, Ministria e Energjisë dhe Çështjeve të Energjetikes, publikon informacion të detajuar mbi procedurat e licencimit në faqen e vetë të internetit.

Burimi: Ministria e Energjisë dhe Çështjeve të Energjetikës,

http://www.energy.gov.tt/investors.php?mid=208

Udhëzimi 5 - 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it . Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 5: Raportet e aktivitetit vjetor

Kërkesa 7.2

Kërkesa 7.2 deklaron se Grupit Ndërinstitucional i kërkohet të shqyrtojë rezultatin dhe ndikimin e zbatimit të EITI-it në qeverisjen e burimeve natyrore.

a) Grupit Ndërinstitucional i kërkohet të publikojë raportet e aktivitetit vjetor. Këto raporte përfshijnë:

   i. Përmbledhje të aktiviteteve të EITI-it për vitin e kaluar;
   i. Vlerësim i progresit duke përdorur si bazë përmbushjen dhe qëndrimin në pajtim me kriteret e EITI-it, si dhe hapat e marrë për të tejkaluar këto kritere. Këtu përfshihet çdo veprim i ndërmarrë për të adresuar çështje të tilla si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (3.7 – 3.8), pagesat për transportin (4.1.f), shpenzimet sociale jo të detyrueshme (4.1.e), transfertat vendore të posaçme (4.2.2), pronësia përfituese (3.11), dhe kontratat (3.12);
   i. Përmbledhje të reagimit të Grupit Ndërinstitucional dhe progresi i bërë kundrejt adresimit të rekomandimeve nga rakordimi dhe miratimi sipas dispozitës 7.1.a. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet të bëjë një listë të secilit rekomandim dhe aktiviteteve korresponduese që janë ndërmarrë për të adresuar rekomandimet;
   i. Vlerësim të progresit në lidhje me përmbushjen e objektivave të përcaktuar në planin e punës (Kërkesa 1.4), duke përfshirë edhe ndikimin dhe rezultatet e këtyre objektivave;
   i. Përshkrim të përpjekjeve për të përforcuar zbatimin e EITI-it, duke përfshirë edhe veprimet e marra për ta bërë më të detajuar dhe për të zgjeruar fushëveprimin e raportimit të EITI-it, apo për të rritur angazhimin me palët e interesuara.

b) Të gjithë palët e interesuara duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në hartimin e raportit për aktivitetin vjetor dhe rishikimin e ndikimit të zbatimit të EITI-it. Grupet e shoqërisë civile dhe industrisë, të përfshira kryesisht në EITI, por jo vetëm ata të përfshirë në Grupin Ndërinstitucional, duhet të jenë në gjendje të japin opinionin e tyre për procesin dhe të reflektojnë pikëpamjet e tyre në raportin për aktivitetin vjetor.

Burimi: *Standardi EITI, f. 33-34*

Siç deklarohet në kërkesën 7.2(a), Grupit Ndërinstitucional i kërkohet të publikojë raportet e aktivitetit vjetor. Qëllimi i këtij raporti është të komunikojë përpjekjet e bëra për të plotësuar dhe/ose ruajtur pajtueshmërinë me kërkesat e EITI-it, duke përfshirë edhe progresin e bërë kundrejt plotësimit të objektivave të përcaktuara në planin e punës, si dhe për të dokumentuar ndikimin e EITI-it.

Standardi EITI (Kërkesa 1.6(c)) shprehet më tej se 'raporti i aktivitetit të vitit të kaluar duhet të publikohet deri më 1 korrik të vitit pasues'. Për shembull, raporti i aktivitetit për vitin 2013 duhet të publikohet deri më 1 korrik 2014. Bordi i EITI-it përcakton afate të përshtatshme për vendet e reja Kandidate për EITI. Kërkesa 1.6(c) shprehet më tej se 'nëse raporti për aktivitetin vjetor nuk publikohet brenda gjashtë muajve të këtij afati – deri më 31 dhjetor të vitit pasues – ai shtet pezullohet derisa Bordi i EITI-it të sigurohet se ka publikuar raportin e vonuar për aktivitetin'.

Në vijim paraqitet një model i një raporti të aktivitetit vjetor:

<Shteti> Raporti i EITI-it për aktivitetin vjetor <viti>

1. Vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

Sipas kërkesës 7.2(a)(i), jepni një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve të EITI-it të ndërmarra vitin e kaluar. Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të shpjegojë si lidhen këto aktivitete me objektivat e planit të punës.

2. Vlerësim i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës

Jepni një vlerësim të progresit të bërë në lidhje me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e punës (Kërkesa 1.4), duke përfshirë edhe ndikimin dhe rezultatet e këtyre objektivave (kërkesa 7.2(a) (iv)).

Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të:

- Rendisë objektivat dhe qëllimet e përcaktuara në planin e punës, dhe të tregojë progresin e bërë për përmbushjen e tyre.
- Shpjegojë aktivitetet e përcaktuara në planin e punës, si dhe të përshkruajë nëse këto aktivitete janë kryer. Të përfshihen edhe aktivitete të tjera, jo të parashikuara në planin e veprimit, por që kanë kontribuar për arritjen e qëllimeve më të mëdha.

3. Vlerësimi i performancës përkundrejt kërkesave të EITI-it

Jepni një vlerësim të progresit të bërë në lidhje me përmbushjen dhe/ose ruajtjen e pajtueshmërisë me secilën prej kërkesave të EITI-it (kërkesa 7.2(a)(ii). Këtu përfshihet çdo veprim i ndërmarrë si përgatitje për të zbatuar Standardin EITI, duke përfshirë edhe adresimin e çështjeve të tilla si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (3.7 – 3.8), pagesat për transportin (4.1.f), shpenzimet sociale jo të detyrueshme (4.1.e), transfertat vendore të posaçme (4.2.2), pronësia përfituese (3.11), dhe kontratat (3.12)

Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të kryejë një vlerësim të secilës kërkesë, duke përdorur tabelën në vijim.

Kërkesat:	Progresi:

4. Përshkrim i përgjigjes së Grupit Ndërinstitucional ndaj rekomandimeve të nxjerra nga rakordimi dhe miratimi, në rast se ka.

Në përputhje me kërkesën 7.2 (a)(iii), bëni një përmbledhje të reagimit të Grupit Ndërinstitucional dhe progresit të bërë në drejtim të adresimit të rekomandimeve nga rakordimi dhe miratimi sipas dispozitës 7.1. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet të rendisë çdo rekomandim dhe aktivitetet korresponduese të ndërmarra për të adresuar rekomandimet.

Grupi Ndërinstitucional mund të dojë të tregojë se si është përditësuar plani i punës për të përfshirë rekomandimet.

5. Pikat e forta apo të dobëta, të identifikuara në procesin EITI

Paraqisni një përshkrim të përpjekjeve për të përforcuar zbatimin e EITI-it, si dhe veprimet e ndërmarra për ta bërë më të detajuar dhe për të zgjeruar fushëveprimin e raportimit të EITI-it, apo për të rritur angazhimin me aktorët (kërkesa 7.2(a)(v)).

Grupi Ndërinstitucional mund të dojë të përfshijë informacion në lidhje me:

- *Si është zgjeruar fusha e raportimit të EITI-it për të përmbushur objektivat e përcaktuara në planin e punës;*
- *Përpjekjet e bëra për të siguruar që Raporti i EITI-it të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit publik, veçanërisht në lidhje me kontributin fiskal të industrisë nxjerrëse dhe mënyrës si këto të ardhura shpërndahen dhe shpenzohen;*
- *Përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin, për të mbështetur dhe ngritur kapacitetin e palëve; dhe*
- *Dobësitë e identifikuara në procesin e EITI-it, si dhe veprimet e ndërmarra për t'i adresuar.*

6. Kostot totale të zbatimit

Grupi Ndërinstitucional mund të dojë të përfshijë informacion në lidhje me zbatimin e kostove. Këtu mund të përfshihet një krahasim i kostove të prodhimit me kostot e planit të punës, të ndara sipas kontribuesit dhe linjave të buxhetit. Mund të përfshihet edhe informacion mbi numrin e punonjësve në sekretariatin kombëtar.

7. Komente shtesë

8. A është diskutuar raporti i aktivitetit përtej Grupit Ndërinstitucional?

Sipas kërkesës 7.2.b, të gjithë aktorët duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në hartimin e raportit për aktivitetin vjetor dhe rishikimin e ndikimit të zbatimit të EITI-it. Grupet e shoqërisë civile dhe industrisë, të përfshira kryesisht në EITI , por jo vetëm ata të përfshirë në Grupin Ndërinstitucional, duhet të jenë në gjendje të japin opinionin e tyre për procesin dhe të reflektojnë pikëpamjet e tyre në raportin për aktivitetin vjetor.

Kjo është një mundësi për Grupet Ndërinstitucionale që të përmirësojnë zotërimin e procesit dhe të sigurojnë që EITI të rrënjoset më thellë në procese më të gjera reformash në vend. Vendet mund të dëshirojnë të përshkruajnë aktivitete më të gjera, ku përfshihen palë të tjera si shoqëria civile dhe kompani, mënyrën si u ftuan për të dhënë mendim mbi procesin, dhe të sigurohen që pikëpamjet e tyre të jenë reflektuar në shqyrtimin e bërë.

9. Detaje të anëtarësisë së Grupit Ndërinstitucional gjatë periudhës (duke përfshirë detaje në lidhje me numrin e takimeve dhe të dhënat në lidhje me pjesëmarrjen)

Miratuar nga Grupi Ndërinstitucional:

Data:

Udhëzimi 6 - 13 nëntor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it . Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 6: Termat e referencës për një studim për Raportin EITI [viti], [vendi], [data]

Informacion

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), është një standard global që promovon transparencën e të ardhurave dhe përgjegjshmërinë në sektorin e industrise nxjerrëse. Ka një metodologji robuste, por edhe fleksibël, për monitorimin dhe rakordimin e pagesave të kompanisë dhe të ardhurat e qeverisë nga nafta, gazi, dhe miniera në nivel kombëtar. Secili prej vendeve zbatuese krijon procesin e vet për EITI, të përshtatur me nevojat specifike të vendit. Zbatimi i EITI-it ka dy përbërës kryesorë:

- Transparenca: Kompanitë e naftës, gazit, dhe minierave i bëjnë publike pagesat ndaj qeverisë dhe qeveria bën publike marrjen e pagesave. Shifrat rakordohen dhe publikohen në Raportet vjetore për EITI-in krahas informacionit kontekstual mbi sektorin e industrise nxjerrëse.

- Përgjegjshmëria: Një Grup Ndërinstitucional me përfaqësues nga qeveria, kompani dhe shoqëria civile është krijuar për të mbikëqyrur procesin dhe për të komunikuar gjetjet e Raportit të EITI-it.

Kërkesat për vendet zbatuese janë përcaktuar në Standardin EITI[3]. Për informacion të mëtejshëm, ju lutem shihni www.EITI.org

Kjo pjesë duhet të japë më tepër informacion të përgjithshëm mbi zbatimin e EITI-it në vend. Këtu duhet të përfshihen ***objektivat e përcaktuara qartë të*** **EITI-it***, siç është rënë dakord nga Grupet Ndërinstitucionale dhe sipas shpjegimit në planin e punës së* EITI-it. *Duhet të jepet një link për planin e punës së* EITI-it*, me një shpjegim shtesë, sipas kërkesës, mbi gjendjen aktuale të Raportimit të* EITI-it.

Në këtë aspekt, [pala kontraktuese] kërkon një firmë apo individ të aftë dhe të besueshëm për të kryer studimin e fushës, në përputhje me Termat e Referencës.

Objektivi i detyrës

Objektivi i detyrës është hartimi i një raporti për të informuar Grupin Ndërinstitucional mbi fushën e veprimit të Raportit të EITI-it [viti], si dhe rekomandime në lidhje me:

- Mbledhjen e informacionit kontekstual të nevojshëm të përcaktuar nga objektivat dhe plani i punës së Grupit Ndërinstitucional, si dhe kërkesat e EITI-it (Kërkesa 3);

[3] http://eiti.org/files/English_EITI%20STANDARD_11July_0.pdf

- Nivelet e pagesave dhe të ardhurave që duhen raportuar, duke përfshirë edhe pragjet e duhura të rëndësishme, sipas rastit (Kërkesa 4.1);
- Nivelet shtesë të përfitimeve nga sektori i industrise nxjerrëse, të cilat duhen raportuar (Kërkesa 4.2);
- Kompanitë, sipërmarrjet shtetërore dhe subjektet qeveritare që priten të raportojnë (Kërkesa 4.3);
- Përmbledhjen e praktikave të auditimit dhe garancitë që duhen ofruar nga subjektet raportuese (Kërkesa 5); dhe
- Adresimin e pengesave që hasen në lidhje me bërjen publike të informacionit të nevojshëm.

Kur adreson këto pika, konsulenti mund të dojë të paraqesë opsionet e mundshme që shtrohen para Grupit Ndërinstitucional, duke mbajtur parasysh objektivat e përgjithshme, kërkesat EITI, dhe burimet e disponueshme. Grupi Ndërinstitucional dhe Administratori i Pavarur hartojnë studimin e fushës duke rënë dakord për fushën e procesit të raportimit sipas 'procedurës së Raportit të EITI-it për të cilën është rënë dakord' (kërkesa 5.2). Këtu mund të përfshihen modifikime dhe përmirësime të fushës së procesit të raportimit të rekomanduar nga konsulenti.

Raporti i konsulentit i prezantohet Grupit Ndërinstitucional dhe bëhet publik.

Objektivi i punës

Konsulenti pritet të kryejë detyrat e mëposhtme:

1. Të shqyrtojë planin e punës së Grupit Ndërinstitucional për të kuptuar qartë objektivat dhe qëllimin e zbatimit të EITI-it. Konsulenti duhet të shqyrtojë edhe raportet e aktivitetit vjetor të krijuara nga Grupi Ndërinstitucional për të parë progresin e bërë në lidhje me përmbushjen e objektivave, si dhe të shqyrtojë veprimet e ndërmarra nga Grupi Ndërinstitucional për të adresuar rekomandimet nga përcaktimet e vlefshmërisë dhe raportimet e mëparshme të EITI-it.
2. Aty ku është e mundur, bëni një përmbledhje të gjithë Raporteve të mëparshme të EITI-it dhe raportin(et) e Përcaktimit të Vlefshmërisë, për të kuptuar qëllimin dhe gjendjen aktuale të procesit të raportimit të EITI-it në [shteti] si dhe vlerësoni fushat ku nevojitet përmirësim i mëtejshëm;

Informacion kontekstual

Shqyrtoni [dhe përmblidhni] kuadrin ligjor për industrinë nxjerrëse (Kërkesa EITI 3.2).

3. Jepni një përmbledhje të tipareve kryesore të sektorit të industrise nxjerrëse (Kërkesa EITI 3.3).

4. Në përputhje me Kërkesën EITI 3.4, bëni një përmbledhje të kontributit të industrise nxjerrëse në ekonomi për [viti].

5. Identifikoni burimet e informacionit për të dhënat e prodhimit dhe komentoni mbi cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave me qëllim për të kontribuar në përqasjen e Grupit Ndërinstitucional për kërkesën EITI 3.5.

6. Aty ku është e mundur dhe në përputhje me Kërkesën EITI 3.6, shqyrtoni rolin e kompanive shtetërore në sektorin nxjerrës dhe sugjeroni një përqasje për raportimin e marrëdhënieve financiare midis qeverisë dhe subjekteve shtetërore, shpenzimet *quasi*-fiskale, zotërimin nga shteti të kompanive të naftës, gazit dhe mineraleve, të cilat operojnë në [shteti]. Këtu duhet të përfshihet edhe identifikimi i pengesave që mund të dalin ndaj bërjes publike gjithëpërfshirëse.

7. Propozoni një kornizë raportimi për ndarjen e burimeve dhe shpërndarjen e të ardhurave në përputhje me Kërkesat EITI 3.7 dhe 3.8.

8. Shqyrtoni informacionin aktual të disponueshëm në lidhje me regjistrat e licencave dhe shpërndarjen e licencave, vlerësoni sa i plotë dhe koherent është informacioni, dhe propozoni një mekanizëm raportimi dhe bërjeje publike të informacionit, në përputhje me Kërkesat EITI 3.9 dhe 3.10.

9. Sipas Kërkesës EITI 3.12(b), shqyrtoni politikën e [shteti] për bërjen publike të kontratave dhe licencave për eksplorim dhe shfrytëzim të naftës, gazit dhe mineraleve. Këtu duhet të përfshihet edhe një përmbledhje e dispozitave ligjore përkatëse dhe reformat e planifikuara apo në zbatim.

10. *Në rastet kur objektivat dhe plani i punës së Grupit Ndërinstitucional kërkojnë informacion kontekstual shtesë, duhet të specifikohet në këtë pikë*.

11. Identifikoni pengesat që hasen në lidhje me bërjen publike të informacionit kontekstual, të përcaktuar më sipër; paraqisni mundësitë e ndryshme dhe bëni rekomandime për adresimin e këtyre pengesave.

Rakordimi i EITI-it

12. Bëni një analizë të plotë të pagesave dhe burimeve të të ardhurave qeveritare në lidhje me sektorin nxjerrës, duke theksuar veçanërisht burimet e të ardhurave që duhet të mbulohen sipas Kërkesës EITI 4.1(b). Analiza duhet të përfshijë edhe të ardhurat nga shitja e aksioneve shtetërore të prodhimit apo të ardhura të tjera në natyrë (4.1.c), ofrimet e infrastrukturës dhe marrëveshje të tjera shkëmbimi (4.1.d), shpenzimet shoqërore të detyrueshme dhe vullnetare (4.1.e), dhe pagesat për transport (4.1.f).

13. Duke mbajtur parasysh gjetjet në pikën (13) më sipër, shqyrtoni të dhënat e kadastrave dhe të ardhurave nga [viti] dhe bëni rekomandime në lidhje me cilat nga këto pagesa taksash dhe burime të të ardhurave qeveritare duhet të konsiderohen kryesore/ materiale. Nëse është e përshtatshme, mund të sugjeroni edhe një prag rëndësie

materiale për bërjen publike të kompanisë (duke iu referuar udhëzimit[4] dhe kërkesës EITI 4.1).

14. Bazuar në përkufizimin e propozuar të rëndësisë materiale, hartoni një listë paraprake të kompanive që bëjnë pagesa të një rëndësie materiale dhe duhen përfshirë në Raportin EITI (Kërkesa EITI 4.2.a). Në rastet kur propozohet një prag rëndësie, duhet të përfshijë edhe një vlerësim të mbulimit të pagesave të kompanisë që do të bëhen publike në krahasim me totalin e të ardhurave qeveritare nga ky sektor. Duhet gjithashtu të identifikohet kontributi total i kompanive, i cili nuk kërkohet nga raporti (d.m.th. ai që është nën pragun e rëndësisë materiale), duke treguar qartë madhësinë relative të secilës kompani. (Ky informacion ndihmon në vlerësimin e gjithëpërfshirjes së Raportit të EITI-it sipas Kërkesës 5.3.c)

15. Aty ku është e mundur, identifikoni për secilën kompani sa më poshtë vijon:

    e) Numrin e Identifikimit të Taksapaguesit të Kompanisë;

    f) Sektorin dhe fazën e operacionit – eksplorim, prodhim, naftë, gaz, minierë, etj;

    g) Llojin e licencës(ave) dhe numrin.

16. Bazuar në përkufizimin e rëndësisë materiale të propozuar, identifikoni se cilat subjekte qeveritare duhet të raportojnë. Duhet vënë në dukje se qeveria duhet të bëjë publike të gjitha të ardhurat, pavarësisht rëndësisë materiale (Kërkesa EITI 4.2.b). Kështu që, në rastet kur është përcaktuar një prag rëndësie materiale për bërjen publike të kompanisë, do të ishte me vend të bëhej një rakordim i pagesave të kompanisë dhe të ardhurave qeveritare sipas pragut të rëndësisë. Të ardhurat shtesë qeveritare (nga kompanitë nën pragun e rëndësisë materiale) duhet gjithashtu të publikohen në Raportin e EITI-it sipas Kërkesës 4.2.b.

17. Në përcaktimin e subjekteve qeveritare që duhet të bëhen publike, konsulenti duhet të identifikojë nëse subjektet qeveritare vendore marrin të ardhura direkte apo indirekte nga sektori nxjerrës, sipas Kërkesës 4.2(d) dhe Kërkesës 4.2(e).

18. Identifikoni pengesat ligjore, rregullatore, administrative, apo praktike ndaj bërjes publike dhe, nëse është e nevojshme, përcaktoni mundësitë dhe bëni rekomandime si mund të adresohen këto pengesa.

[4] http://eiti.org/document/guidance-notes

Çështje që kërkojnë vëmendje të veçantë

Nëse ka çështje të rëndësishme në procesin e raportimit të *EITI-it, të cilat kërkojnë përcaktim më të detajuar të fushës, si p.sh shitja e naftës, tranziti, etj., duhet të shtohen këtu detyrat specifike si dhe referencat nga dokumentacioni i përshtatshëm mbështetës.*

Cilësia e të dhënave

19. Në rast se Raportet EITI janë nxjerrë tashmë, shqyrtoni përqasjet e mëparshme të adresimit të cilësisë së të dhënave, duke përfshirë edhe rekomandimet nga Administratori apo Miratuesi i Pavarur për të përforcuar procesin. [Shtoni referencat nga diskutimet e Grupit Ndërinstitucional dhe veprimet e rëna dakord në lidhje me këto çështje.]

20. Sipas Kërkesës EITI 5.2(b), shqyrtoni procedurat e auditimit dhe garantimit të kompanive dhe subjekteve qeveritare që mund të marrin pjesë në procesin e raportimit të EITI-it, duke përfshirë edhe ligjet dhe rregulloret përkatëse, reformat e planifikuara apo në proces, dhe shqyrtoni nëse këto procedura janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

21. Sipas Kërkesës EITI 5.2(c), propozoni garancitë që subjektet raportuese duhet t'i ofrojnë Administratorit të Pavarur.

Prezantim

22. Përgatisni dhe i paraqisni projekt-studimin e sferës Grupit Ndërinstitucional, [pala kontraktuese], dhe Sekretariatit Ndërkombëtar për rishikim dhe komente;

23. Përgatisni një studim përfundimtar të sferës për Grupin Ndërinstitucional dhe jepni rekomandime për raportin e EITI-it për;

24. Rekomandoni si mund të përmirësohen raportet e ardhshme mbi sferën.

Produktet

Shtoni informacion mbi rezultatet (raporti fillestar, projekt-raporti, raporti përfundimtar) dhe afati kohor.

Kriteret që duhet të përmbushë konsulenti

Konsulenti duhet të ketë:

- Aftësi teknike dhe financiare, si dhe njohuri dhe eksperiencë pune në lidhje me transparencën dhe qeverisjen, financat publike dhe përgjegjshmërinë financiare, si dhe dialogun mes shumë palëve. Preferohet të ketë eksperiencë me EITI-in.

- Njohuri të sektorit të naftës, gazit dhe mineraleve apo të burimeve të tjera natyrore, mundësisht brënda vendit.
- Eksperiencë (që mund të vërtetohet) në fusha të ngjashme.

[*Informacion mbi aftësi dhe kompetenca të tjera të kërkuara, ditët në staf, etj.*]

Masat administrative

Jepni informacion mbi linjat e raportimit, mbështetje për konsulentin gjatë detyrës, si dhe masa të tjera logjistike dhe administrative

Referenca:

- **Standardi EITI-it**, veçanërisht Kërkesat 2-5, http://NTIN.org/document/standard
- **Udhëzimet e zbatimit të EITI-it** nga Sekretariati Ndërkombëtar, http://NTIN.org/document/guidance-notes, veçanërisht udhëzimet për fushën e veprimit dhe përcaktimin e rëndësisë materiale. Konsulenti këshillohet të kontaktojë Sekretariatin Ndërkombëtar të EITI-it për çdo pyetje apo paqartësi në lidhje me Standardin EITI dhe zbatimin e kërkesave të EITI-it;
- **Procedurat e rëna dakord për Administratorët e Pavarur**, duke përfshirë edhe format standarde të raportimit të EITI-it, të cilat mund të merren nga Sekretariati Ndërkombëtar;
- Zbatimi i EITI-it për Ndikim *(Implementing EITI for Impact*): Manual për Politikë-bërësit dhe Aktorët, veçanërisht kapitujt 4 dhe 5;
- Shembuj nga studime mbi fushën e veprimit, të cilat mund të merren nga Sekretariati Ndërkombëtar; dhe
- Çdo burim tjetër informacioni, duke përfshirë Raportet e EITI-it*, informacion mbi sistemet e licencave, etj.*

Udhëzimi 7 - dhjetor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 7: Transparenca e kontratave

Kërkesa 3.12

1. Përmbledhje

Kontratat, licencat dhe marrëveshjet e asociuara përcaktojnë angazhimet ndërmjet qeverisë dhe kompanive në industritë nxjerrëse[5]. Në disa raste, termat e këtyre kontratave dhe licencave mund të jenë standarde dhe të plotësuara nga regjimet tatimore. Në raste të tjera, këto kontrata, licenca dhe marrëveshje përfshijnë terma të detajuar se si pronarë të burimeve dhe kompanitë arrijnë të ndajnë riskun dhe shpërblimin gjatë kohëzgjatjes së projekteve afatgjata të nxjerrjes së pasurive natyrore. Kushtet fiskale trajtojnë mënyrën se si kostot dhe përfitimet ndahen ndërmjet palëve dhe se si duhen llogaritur dhe paguar taksat, rentat dhe tarifat e tjera të nxjerrjes.

Parimi 6 i EITI-it njeh që arritja e transparencës duhet vendosur në kontekstin e respektit për kontratat dhe ligjet. Standardi i EITI-it kërkon që Raporti i EITI-it të dokumentojë politikën e qeverisë për publikimin e kontratave dhe licencave qe udhëheqin kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve (kërkesa 3.12b). Standardi EITI-it gjithashtu nxit shtetet zbatuese të publikojnë kontratat dhe marrëveshjet që përcaktojnë kushtet për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve (kërkesa 3.12a). Kërkesat e EITI-it parashtrohen të plota në kutinë 1.

Ky udhëzim parashtron çështje që Grupi Ndërinstitucional duhet të marrë parasysh për të arritur kërkesat e dokumentimit të politikave dhe praktikave të qeverisë rreth publikimit. Udhëzimi gjithashtu parashtron disa opsione të mundshme rreth mënyrës se si Grupi Ndërinstitucional duhet të strukturojë një sistem për publikimin e kontratave nëse ai do të trajtojë transparencën e kontratave.

Disa shtete zbatuese të EITI-it (Nigeria, Sao Tome dhe Principe dhe Sierra Leone) kanë miratuar ligje që kërkojnë publikimin e kontratave. Shtete të tjera, (Afganistani, Azerbajxhani, Republika Demokratike e Kongos, Liberia, Guinea, Peruja, Republika e Kongos dhe Timori Lindor) kanë publikuar të gjitha apo disa nga kontratat e tyre rreth industrisë nxjerrëse. Në disa shtete zbatuese, thuhet se kontratat janë konfidenciale dhe prandaj nuk publikohen. Në ato shtete qe i publikojnë kontratat zakonisht mund

[5] Termat "kontratë" dhe "licencë" janë përdorur sipas përcaktimit të kërkesës 3.12(c) dhe 3.12(d) të parashtruara më poshtë

të gjenden në faqe interneti të qeverisë. Gjithashtu, disa kompani kanë kërkuar në mënyrë proaktive qe kushtet e kontratave të jenë të gjindshme në mënyrë që të mund të shqyrtohen.

Duke qenë se transparenca e kontratave është një fushë relativisht e re brenda EITI-it, është e mundshme që ky udhëzim të rishikohet për të reflektuar praktikat që do të dalin. Duke qenë se publikimi i kontratave mund të ketë ndjeshmëri tregtare, Sekretariati Ndërkombëtar nxit shtetet zbatuese që dëshirojnë ta trajtojnë këtë çështje të konsultohen në mënyrë të gjerë me të gjithë palët, përfshirë palët e interesuara jashtë Grupit Ndërinstitucional, dhe të kërkojë arritjen e konsensusit në lidhje me çdo vendim që lidhet me transparencën e kontratave.

Kutia 1 – Mbulimi i transparencës së kontratave në Standardin e EITI-it

Kërkesa 3.12 parashtron kërkesat e raportimit në lidhje me kontratat:

a) Shtetet zbatuese inkurajohen të publikojnë çdo kontratë dhe licencë që përfshin kushtet rreth shfrytëzimit të naftës, gazit dhe mineraleve

b) Kërkohet që Raporti i EITI-it të dokumentojë politikën e qeverisë rreth publikimit të kontratave dhe licencave që udhëheqin kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë dispozitat përkatëse ligjore, praktikat për publikimin dhe çdo reformë të planifikuar apo që është duke u zbatuar. Kur është e zbatueshme, Raporti i EITI-it duhet të ofrojë një panoramë të kontratave dhe licencave që janë të disponueshme publikisht dhe të përfshijë një referencë apo link të vendit se ku janë publikuar.

c) Termi kontratë në kërkesën 3.12(a) do të thotë:
   - Teksti i plotë i çdo kontrate, koncesioni, marrëveshjeje për ndarjen e prodhimit apo marrëveshjeje të pranuar apo ku merr pjesë qeveria, e cila përfshin kushtet në lidhje me shfrytëzimin e naftës, gazit dhe pasurive minerare;
   - Teksti i plotë të çdo shtojce, ndryshimi apo përfundimi që përcakton detaje në lidhje me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në kërkesën 3.12(c)(i) apo ekzekutimin e saj; dhe
   - Teksti i plotë i çdo ndryshimi të bërë dokumenteve të përshkruara në kërkesat 3.12(c)(i) dhe 3.12(c)(ii).

d) Termi licencë në kërkesën 3.12(a) do të thotë:
   - Teksti i plotë i çdo licence, kontratë qiraje, titulli apo lejeje me anë të së cilës qeveria i jep një apo disa kompanive apo individëve të drejtën për të shfrytëzuar gazin dhe/ose pasuritë minerare;
   - Teksti i plotë i çdo shtojce, ndryshimi apo përfundimi që përcakton detaje në lidhje me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në kërkesën 3.12(d)(i) apo ekzekutimin e saj;
   - Teksti i plotë i çdo ndryshimi të bërë dokumenteve të përshkruara në kërkesat 3.12(d)(i) dhe 3.12(d)(ii)

Burimi: Standardi i EITI-it, f.25.

2. Orientim

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it i rekomandon Grupeve Ndërinstitucionale qasjen hap-pas-hapi si më poshtë për të trajtuar nxitjen e transparencës së kontratave:

1. Për të siguruar që Raporti i EITI-it dokumenton politikën e qeverisë rreth publikimit të kontratave (siç kërkohet në kërkesën 3.12.b), Grupi Ndërinstitucional këshillohet të identifikojë ligjet përkatëse, rregullat dhe sistemet financiare që udhëheqin sektorin

nxjerrës dhe të përcaktojë nëse ata përmbajnë apo jo dispozita rreth publikimit dhe çfarë thonë rreth tij.

Pyetje që ndihmojnë për të bërë dokumentimin e politikës së qeverisë rreth publikimit të kontratave:

- Cilat janë ligjet dhe rregullat përkatëse kombëtare dhe vendore? Vini re se Kërkesa 3.2 thotë që "Raporti i EITI-it duhet të përshkruajë kuadrin ligjor dhe regjimin fiskal që udhëheqin industrinë nxjerrëse."
- Cilat kushte që zbatohen për kontratat e naftës, gazit dhe minierave përcaktohen në legjislacion dhe rregullore? A janë këto ligje dhe rregulla të aksesueshme publikisht?
- A ka sistem taksash/rentash (licenca dhe koncesione) apo sistem kontrate (MNP, kontratë shërbimi, etj.)?
- A mund të identifikohet agjencia/agjencitë përgjegjëse për dhënien e licencave apo për negocimin dhe firmosjen e kontratave të naftës, gazit dhe minierave?
- A mund të identifikohet agjencia/agjencitë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kontratave të naftës, gazit dhe minierave?
- A mund të identifikohet ndonjë pengesë apo kufizim ligjor për publikimin e kontratave?
- A ka qeveria një kontratë model për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe minierave? A ndiqet ky model për të gjitha kontratat?
- A është në proces ndonjë reformë që mund të ndikojë në aksesin publik të kontratave?

2. Në disa raste, ligjet dhe rregullat mund të parashikojnë publikimin e kontratës, por kjo mund të mos reflektohet në praktikën reale të publikimit. Në raste të tjera, kontratat mund të publikohen në praktikë, edhe nëse ligjet dhe rregullat nuk e parashikojnë një gjë të tillë. Ka raste kur kontratat mund të jenë konfidenciale dhe publikimi është i ndaluar. Ligje dhe kontrata të tjera mund të mos e përmendin një gjë të tillë. Sipas kërkesës 3.12.b, Raporti i EITI-it duhet të dokumentojë praktikën reale të publikimit. Në trajtimin e kësaj kërkese, Grupi Ndërinstitucional mund ta ketë të nevojshme të vlerësojë nëse:
   - te gjitha kontratat publikohen, pavarësisht nga lloji i tyre;
   - kontratat publikohen të plota, duke përfshirë ndonjë shtesë që mund të kenë;
   - kontratat publikohen në kohë;
   - kontratat bëhen të disponueshme dhe aksesi në to është i lehtë;
   - publikohen kushtet kryesore të kontratave apo një përmbledhje e tyre;

- kontratat publikohen, përveç disa informacioneve me ndjeshmëri tregtare apo teknike që redaktohen;
- publikohen kontratat e përfunduara pas një date të përcaktuar dhe konsistente.

3. Sipas kërkesës 1.4.f, Grupi Ndërinstitucional duhet të marrë parasysh trajtimin e çështjeve, si publikimin e kontratave kur rishikojnë planin e punës të EITI-it. Shtetet zbatuese nxiten të publikojnë çdo kontratë dhe licencë që përfshin kushtet për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve (kërkesa 3.12(a). Kur politika e qeverisë nuk trajton në mënyrë të qartë publikimin e kontratave, dhe kur kjo është diçka që dëshiron ta trajtojë Grupi Ndërinstitucional, mund të merren parasysh metodat e mëposhtme për sistemin e publikimit të kontratave, duke marrë parasysh të drejtat e palëve kontraktuese dhe interesin e publikut:

   - Publikimi i kontratave që japin kontribut apo pritet të japin kontribut më shumë se një përqindje e caktuar e të gjithë të ardhurave të qeverisë apo tejkalojnë një prag të caktuar të volumit të prodhimit.
   - Publikimi i kushteve të caktuara, pjesë e një kontrate që janë me interes të veçantë për palët, domethëne kushte financiare apo detyrime sociale dhe ambientale.
   - Publikimi i çdo kontrate në të ardhmen (d.m.th. kontratat e firmosura pas një date të caktuar).
   - Publikimi i një përmbledhjeje të kushteve kryesore sipas të cilave zhvillohet pasuria. Kjo përmbledhje mund të përfshijë për shembull kohëzgjatjen e kontratës; ndonjë pagesë për materialet të bëra nga qeveria; kushte fiskale të tjera materiale; dhe një përmbledhje të ndonjë klauzole të rëndësishme stabilizuese.
   - Mundësia për të redaktuar informacionet me ndjeshmëri tregtare.
   - Publikim i plotë i kontratës.

4. Pasi merr parasysh çështjet e nënvizuara më sipër, Grupi Ndërinstitucional duhet të bie dakord se çfarë informacioni specifik do të përfshijë rreth transparencës së kontratës në Raportin e EITI-it, dhe rreth formatit sipas të cilit do të jepet ky informacion. Raporti duhet të përfshijë të paktën elementët e mëposhtëm (kërkesa 3.12.b):
   - Një përmbledhje të shkurtër të politikës së qeverisë rreth publikimit të kontratave në Raportin e EITI-it, duke përfshirë komente rreth dispozitave ligjore përkatëse, praktikat e publikimit dhe çdo reformë që planifikohet të kryhet apo që është duke u kryer. Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë gjithashtu të shtojë një panoramë të disa kontratave të nxjerra gjatë periudhës që mbulohet nga Raporti i EITI-it, që kanë gjasa të gjenerojnë të ardhura të mëdha.
   - Kur kontratat publikohen, një panoramë të kontratave dhe licencave që janë të disponueshme publikisht, dhe një referencë apo link se ku mund të aksesohen.
   - Kur kontratat publikohen, por nuk janë të aksesueshme lehtë, Grupi Ndërinstitucional mund të marrë parasysh publikimin e tyre në faqen zyrtare të

EITI-it. Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të marrë parasysh mundësitë për të lidhur këtë informacion me fitimet dhe me të dhëna të tjera në Raportin e EITI-it.

5. Në mënyrë që të jetë i dobishëm dhe që të japë kontribut në debatin publik, Raporti i EITI-it duhet të jetë i kuptueshëm (Kërkesa 6.1.c). Kur kontratat publikohen, Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të rishikojë veprimtaritë e nevojshme për rritjen e kapaciteteve, për të siguruar të kuptuarit e përbashkët të kontratave brenda Grupit Ndërinstitucional dhe ndërmjet aktorëve të tjerë të rëndësishëm me qëllim për të siguruar një përdorim të efektshëm dhe të shëndetshëm të informacioneve të kontratave.

3. Shembuj

Pas miratimit të Kodit të Minierave të vitit 2011, i cili kërkon transparencën e kontratave, qeveria e Guineas ka publikuar të gjitha kontratat e minierave dhe marrëveshjet e lidhura që nga viti 1958, në një faqe interneti të dedikuar, e cila lejon kërkim të plotë brenda dokumenteve dhe përfshin përmbledhje të marrëveshjeve.

Burimi: Komisioni Teknik për Rishikimin e Kontratave të Minierave

http://www.contractsminiersguinee.org/about/projects.html

Në Liberi, LEITI ka një bibliotekë të kontratave dhe koncesioneve që përmban të gjitha kontratat e industrise nxjerrëse të firmosura nga qeveria. Akti i LEITI-it (2009) i lejon LEITI-it të "Përkrahë publikimin e kontratave dhe koncesioneve rreth nxjerrjes të burimeve pyjore the minerale."

Prandaj, në vitin 2012, Sekretariati i LEITI-it siguroi dhe publikoi në faqen e tij zyrtare për përdorim publik më shumë se 100 marrëveshje koncesionare, kontrata, leje, dhe licenca rreth sektorëve të naftës, minierave, pyjeve dhe bujqësisë. Zyra e Sekretariatit vë në dispozicion dhe kopje në letër.

Sekretariati i LEITI-it pranon që është e vështirë për qytetarin e zakonshëm që të kuptojë kushtet dhe dispozitat, për arsye të natyrës së tyre ligjore të ndërlikuar. Prandaj, LEITI siguron ekspertë për shërbime ligjore për të hartuar variante, që mund të kuptohen më lehtë të të gjitha marrëveshjeve të koncesioneve të naftës, minierave, bujqësisë dhe pyjeve. Ata përmbledhin kushtet fiskale, fillimin dhe përfundimin e kontratave, përfitimet e publikut, dhe dispozita të tjera të rëndësishme të marrëveshjeve.

Burimi: LEITI, http://www.LEITI.org.lr/

Qeveria e Afganistanit ka publikuar disa kontrata në faqen e internetit të Ministrisë së Minierave dhe Naftës. Në datë 6 Qershor, presidenti Hamid Karzai nxori një dekret që angazhonte qeverinë për të "publikuar të gjitha kontratat me detaje" të bëra me kompani vendase dhe ndërkombëtare, gjatë tere viteve të fundit, dhe për të finalizuar një plan të transparencës së kontratave të bazuar në "parime ndërkombëtare për të cilat është rënë dakord dhe duke marrë parasysh të ardhmen e vendit."

Deri tani janë publikuar më shumë se 200 kontrata. Po diskutohet me AEITI-it për publikime të mëtejshme, përfshirë publikimin e kontratës për minierën e bakrit të Aynak-ut.

Burimi: Ministria e Minierave dhe Naftës, Afganistan http://mom.gov.af/en/page/1384

Për informacione të mëtejshme, shihni:

http://www.resourcecontracts.org/

http://strikingpoverty.worldbank.org/c121031

http://www.contractroadmap.org

http://openoil.net/contracts-booksprint

http://www.revenuewatch.org/publications/contracts-confidential-ending-deals-extractive-industries

www.open-contracting.org

http://www.eisourcebook.org/642_5PolicyLegalandContractualFramework.html

Udhëzimi 8 - dhjetor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it . Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org

Udhëzimi 8: Mbikëqyrja e ciklit të raportimit të EITI-it nga Grupi Ndërinstitucional

1. **Përmbledhje**

EITI kërkon mbikëqyrje të efektshme nga Grupi Ndërinstitucional (kërkesa 1). Një funksion thelbësor i Grupit Ndërinstitucional është mbikëqyrja e raportimit periodik të EITI-it. Kërkesat 2-6 të Standardit të EITI-it përqendrohen në afatet kohorë, informacionin kontekstual, plotësinë, besueshmërinë dhe shpërndarjen e Raporteve të EITI-it (shih kutinë 1). Kërkesa 7 përqendrohet në mësimet e marra dhe në rinovimin e procesit të EITI-it. Ky udhëzim ofron udhëheqje për Grupin Ndërinstitucional rreth disa nga sfidat kryesore që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e ciklit të raportimit të EITI-it, duke përdorur përvojat e shteteve zbatuese. Udhëzimi gjithashtu përmend materialet e udhëheqjes që Grupet Ndërinstitucionale mund të dëshirojnë të shohin më me hollësi.

Kutia 1 – Kërkesat e EITI-it

EITI kërkon:

1. Mbikëqyrje të efektshme nga Grupi Ndërinstitucional.
2. Publikim në kohë të Raporteve të EITI-it.
3. Raporte të EITI-it të cilat përfshijnë informacion kontekstual rreth industrive nxjerrëse.
4. Nxjerrjen e Raporteve të plota të EITI-it që përfshijnë publikimin e plotë nga qeveria të të ardhurave nga industria nxjerrëse dhe publikimin e të gjitha pagesave materiale të bëra ndaj qeverisë nga kompanitë e naftës, gazit dhe minierave.
5. Asnjë proces të besueshëm garantimi që zbaton standardet ndërkombëtare.
6. Raporte të EITI-it që janë të plota, promovohen në mënyrë aktive, të aksesueshme publikisht, dhe që japin kontribut në debatin publik.
7. Grupi Ndërinstitucional të ndërmarrë hapa për të vepruar rreth mësimeve të marra dhe të kontrollojë rezultatet dhe ndikimin e zbatimit të EITI-it.

Burimi: Standardi i EITI-it, faqe 10

Udhëzimi është strukturuar rreth një "Cikli të Raportimit të EITI-it " (shih figurën 1). Është e rëndësishme të theksohet që ky model nuk ka për qëllim të mbulojë të gjithë objektivat, vendimet dhe veprimtaritë që do të ndërmerren nga Grupi Ndërinstitucional në lidhje me Raportimin e EITI-it. Në shumë raste, zbatimi i EITI-it do të devijojë nga ky model. Sidoqoftë, modeli është një pikë reference e dobishme për të theksuar disa nga hapat kryesorë gjatë procesit dhe sfidat e përbashkëta të hasura nga shtetet zbatuese. Lexuesve i këshillohet të referohen tek standardet e EITI-it për të verifikuar kërkesat e detajuara, që duhen përmbushur për të pasur përputhshmëri.

2. Orientim

Figura 1 tregon një cikël raportimi të EITI-it të thjeshtuar, duke konturuar 10 hapa kryesorë (shih figurën 1). Udhëheqja më poshtë trajton secilin hap me radhë.

Figura 1 – Cikli i raportimit të EITI-it i thjeshtuar

Hapi 1 Përcaktimi i objektivave dhe planit të punës së EITI-it
Hapi 2 Kërkimin e fushës paraprake apo të përditësuar të veprimit
Hapi 3 Rënia dakord për termat e referencës për Administratorin e Pavarur
Hapi 4 Caktimi i Administratorit të Pavarur
Hapi 5 Konfirmimi i procedurave të raportimit (Raporti i nisjes)
Hapi 6 Mbledhja e të dhënave, verifikimi dhe rakordimi
Hapi 7 Rishikimi i projekt Raportit të EITI-it
Hapi 8 Miratimi dhe publikimi i Raportit përfundimtar të EITI-it
Hapi 9 Nxitja dhe promovimi i debatit publik
Hapi 10 Rishikimi dhe raporti i veprimtarisë vjetore

Hapi 1 – Përcaktimi i objektivave të EITI-it dhe rënia dakord për planin e punës të EITI-it

Kërkesa 1.4 e Standardit kërkon që Grupi Ndërinstitucional të bëjë një plan aktual pune, kostoja e të cilit i cilit duhet të jetë plotësisht e llogaritur dhe në përputhje me raportimin e EITI-it dhe afatet kohore të miratimit të përcaktuara nga bordi i EITI-it. Plani i punës duhet të përcaktojë objektivat e zbatimit të EITI-it që lidhen me Parimet e EITI-it dhe të reflektojë prioritetet kombëtare. Plani i punës së EITI-it krijon themelin për zbatimin e EITI-it dhe për të siguruar që veprimtaritë e zbatimit të kenë si synim dhënien e rezultateve të dëshiruara nga aktorët. Bazuar në Standardin EITI dhe në diskutimet rreth sfidave dhe prioriteteve për industritë nxjerrëse, Grupi Ndërinstitucional, në konsultim me aktorët kryesorë, duhet të zhvillojë një plan pune që tregon se përse zbatohet EITI dhe çfarë çështjesh do të përpiqet të trajtojë procesi i EITI-it. EITI është i rëndësishëm në mënyra të ndryshme në

shtete të ndryshme. Ai zbatohet për të trajtuar shqetësime konkrete rreth korrupsionit, mungesës së besimit, menaxhimin e efektshëm të pasurive natyrore, përfshirë alokimin e të ardhurave, apo për të tërhequr investimet e huaja direkte. Në mënyrë që raportet e EITI-it të përmbajnë informacione të rëndësishme për objektivat më të gjerë të zbatimit të EITI-it, këto objektiva dhe veprimtari që lidhen me to duhen përmendur qartë dhe të lidhen me ciklin e raportimit të EITI-it. Një udhëzim për zhvillimin e një plani pune të EITI-it është i disponueshëm në Sekretariatin Ndërkombëtar të EITI-it.

Hapi 2 – Kërkimi paraprak i fushës së veprimit

Puna për kërkimin e fushës së veprimit ka për qëllim identifikimin e asaj që duhet të mbulojë Raporti i EITI-it në lidhje me burimet e të ardhurave, kompanitë dhe subjektet e qeverisë që duhet të marrin pjesë në procesin e raportimit dhe në punët e tjera përgatitore të nevojshme për të siguruar që raporti i EITI-it bëhet në kohë, është i plotë, i besueshëm dhe i kuptueshëm. Kërkimi paraprak i fushës së veprimit jep bazat për zhvillimin e termave të referencës për Administratorin e Pavarur dhe për firmën e punësuar për të bërë rakordimin. (shih hapin 3). Zakonisht përfshin të parit e çështjeve si më poshtë:

- të raportohet periudha fiskale;
- informacioni kontekstual duhet të përfshihet në Raportin e EITI-it;
- të përcaktohet se cilat burime të ardhurash nga nafta, gazi dhe minierat janë domethënëse dhe, për pasojë, cilat kompani dhe subjekte të qeverisë duhet të raportojnë; dhe
- rishikimi i llojeve të garancive që nevojiten për të siguruar që të dhënat e dorëzuara nga subjektet raportuese janë të besueshme.

Në disa raste, kërkimi i fushës së veprimit mund të hetojë çështje të caktuara apo sfida me më hollësi me qëllim për të identifikuar mundësitë apo zgjidhjet që do të merren parasysh nga Grupi Ndërinstitucional. Gjithashtu mund të përfshije rishikimin e ndonjë sistemi ekzistues, si për shembull për publikimin e përfituesve të licencave, të dhënat e prodhimit apo informacion rreth të ardhurave nga sektori nxjerrës me qëllim të sigurohet që EITI i mbulon këto sisteme kur janë të disponueshme apo përdoret si mjet për përmirësimin e sistemeve kur është e nevojshme.

Një çështje që kërkon rënie dakord nga Grupi Ndërinstitucional ka të bëjë me faktin se kush do të hartojë seksione të ndryshme të raportit të EITI-it. Në shumicën e rasteve, Grupet Ndërinstitucionale ia kanë dhënë si detyrë Administratorit të Pavarur të përgatisë të gjithë Raportin e EITI-it. Sidoqoftë, po bëhet shumë e zakonshme që Grupi Ndërinstitucional të hartojë një pjesë përshkruese me informacion rreth sektorit dhe të dhëna përmbledhëse kyçe, duke i bashkëlidhur raportin bashkërenditës të Administratorit të Pavarur. Tani, standardi i EITI-it kërkon një sasi të konsiderueshme informacioni kontekstual (kërkesa 3). Grupi Ndërinstitucional duhet të bie dakord rreth procedurave dhe përgjegjësive për përgatitjen e informacionit kontekstual për Raportin e EITI-it, duke siguruar që i gjithë informacioni dhe analiza qartëson burimet.

Një numër gjithnjë e më i madh shtetesh kryejnë studime të fushës së veprimit për këtë

qëllim. Shtetet zbatuese që kanë hartuar tashmë një apo disa Raporte të EITI-it duhet që gjithashtu të rishikojnë fushën e veprimit të raportimit të EITI-it në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në objektivat e planit të punës, strukturën e industrisë, regjimet fiskale dhe luhatjet e të ardhurave. Grupet Ndërinstitucionale këshillohen të rishikojnë fushën e veprimit përpara secilit cikël raportimi, përfshirë rishikimin e ndonjë rekomandimi nga Administratori i Pavarur dhe nga Miratuesi në lidhje me çështjet e fushës së veprimit. Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it vë në dispozicion një listë kontrolli për fushën e veprimit të Raportit të EITI-it dhe termat e referencës për studime të fushës së veprimit.

Hapi 3 – Termat e referencës për Administratorin e Pavarur

Termat e Referencës paraqesin punën që do të kryhet nga Administratori i Pavarur. Zakonisht i bashkëlidhet kontratës ndërmjet Administratorit të Pavarur dhe qeverisë. Kërkohet që Grupi Ndërinstitucional të aprovojë Termat e Referencës (kërkesa 5.2). Bordi i EITI-it ka rënë dakord për një shabllon të Termave të Referencës. Ajo përfshin "procedura për të cilat është rënë dakord" për hapa kyç të procesit të raportimit, duke përfshirë:

- rënien dakord për fushën e veprimit të raportimit të EITI-it;
- zhvillimin e shablloneve/formularëve të raportimit;
- nevojën për dokumentacion mbështetës për të siguruar besueshmërinë e të dhënave;
- procedurën për mbledhjen e të dhënave; dhe
- hetimin e mospërputhjeve sipas kërkesave të EITI-it.

Bordi i ka zhvilluar këto procedura për të përkrahur një përputhshmëri dhe besueshmëri më të madhe në raportimin e EITI-it. Përdorimi i shabllonit nuk garanton përputhshmëri. Grupi Ndërinstitucional duhet të sigurohet që procesi i raportimit të EITI-it është rigoroz, i plotë dhe i besueshëm.

Bordi gjithashtu rekomandon që procesi të bazohet sa më shumë është e mundur në procedurat dhe institucionet ekzistuese, domethënë në mënyrë që procesi i EITI-it të bazohet, plotësojë dhe vlerësojë në mënyrë kritike grumbullimin ekzistues së të dhënave dhe sistemet e kontrollit. Në këtë mënyrë, procesi i EITI-it ka potencialin të gjenerojë rekomandime të rëndësishme për të forcuar sistemet e tjera të mbikëqyrjes.

Shablloni i lejon Grupi Ndërinstitucional të listojë objektiva dhe veprimtari të tjera për tu ndërmarrë nga Administratori i Pavarur sipas planit të punës së Grupit Ndërinstitucional. Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it ofron këshilla të mëtejshme rreth plotësimit të shabllonit.

Hapi 4 – Caktimi i Administratorit të Pavarur

Kërkohet që Administratori i Pavarur të shihet nga Grupi Ndërinstitucional si i besueshëm dhe si i aftë teknikisht (kërkesa 5.10). Me qëllim miratimin e Termave të Referencës (kërkesa 5.2). rekomandohet që Grupi Ndërinstitucional të bjerë dakord rreth procedurës për prokurimin dhe kontraktimin e Administratorit të Pavarur. Shtetet zbatuese shpesh kanë hasur vonesa në procesin e prokurimit. Rekomandohet që Grupi Ndërinstitucional

të hetojë paraprakisht procedurat e prokurimit dhe kohën e nevojshme për emërimin e Administratorit të Pavarur dhe që ky afat kohor të reflektohet në planin e punës së EITI-it. Grupi Ndërinstitucional gjithashtu këshillohet të monitorojë nga afër procesin dhe të ndërmarrë veprime për të trajtuar rastet e vonesave.

Hapi 5 – Konfirmimi i fushës së veprimit dhe procedurave të raportimit (Raporti i nisjes)

Shablloni i termave të referencës për Administratorin e Pavarur parashtron pesë fazat e punës (shih figurën 2).

Figura 1 – Panoramë e punës dhe rezultateve nga Administratori i Pavarur

Objektivi i fazës së parë të punës është të konfirmojë fushën e veprimit të procesit të raportimit të EITI-it (duke vazhduar punën e bërë në hapin 2), shablloneët e raportimit, procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe planin për publikimin e Raportit të EITI-it . Gjetjet nga kjo fazë e parë duhen dokumentuar në një raport nisjeje të hartuar nga Administratori i Pavarur në konsultim me Grupi Ndërinstitucional. Ky raport duhet të përfshijë:

- Hollësi rreth mënyrës se si të përfshihet informacioni kontekstual në Raportin e EITI-it;
- Një panoramë të fushës së veprimit të propozuar për procesin e raportimit, duke përfshirë një propozim për një përcaktim të përshtatshëm të materialitetit dhe pragjeve përkatëse;
- Një listë të subjekteve të cilëve do t`iu kërkohet të raportojnë;
- Shabllonet e raportimit që do të plotësohen nga subjektet raportuese;
- Hollësi rreth garancive dhe dokumentacionit mbështetës që do të kërkohet nga subjektet raportuese;
- Procedurat për mbledhjen e të dhënave dhe për rakordimin, duke përfshirë trajnim të përshtatshëm dhe udhëheqje për subjektet raportuese;
- Një afat kohor për finalizimin e Raportit të EITI-it.

Kur është e nevojshme, raporti i nisjes duhet gjithashtu të theksojë ndonjë çështje të pazgjidhur apo barriera të mundshme që mund të pengojnë zbatimin e efektshëm, si dhe zgjidhjet e mundshme për tu marrë parasysh nga Grupi Ndërinstitucional. Grupi Ndërinstitucional duhet të rishikojnë raportin e nisjes së Administratorit të Pavarur dhe të miratojnë fushën e propozuar të veprimit, mbledhjen e të dhënave dhe procedurat e rakordimit përpara nisjes së mbledhjes së të dhënave. Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të bëjë publik raportin e nisjes.

Hapi 6 – Mbledhja e të dhënave, verifikimi dhe rakordimi

Fazat dy dhe tre të punës të Administratorit të Pavarur janë grumbullimi i të dhënave dhe rakordimi fillestar. Procedura më e zakonshme për grumbullimin e të dhënave është që Administratori ka mandat për të shpërndarë shabllonet e raportimit dhe për të mbledhur formularët e plotësuar (dhe dokumentet mbështetës përkatës) drejtpërdrejtë nga subjektet raportuese pjesëmarrëse. Ndërsa propozohet dhe një qasje alternative – p.sh. sekretariati kombëtar mund të ndihmojë me grumbullimin e të dhënave, apo të dhënat mund të grumbullohen nga mekanizmat ekzistuese të raportimit – duhen bërë konsultime me Administratorin e Pavarur për të siguruar që ka procedura të përshtatshme për të mbrojtur integritetin e procesit. Grupi Ndërinstitucional duhet të punojë me Administratorin e Pavarur për tu siguruar që kërkesa për të dhëna përfshin udhëzimet e përshtatshëm rreth mënyrës për të kërkuar informacione dhe mbështetje të mëtejshme.

Pastaj, Administratori i Pavarur krijon një bazë të dhënash me të dhënat e ofruara nga subjektet raportuese dhe përgatit një raport fillestar rakordimi që bazohet në të dhënat e raportuar (të pa rregulluara) për tu marrë parasysh nga Grupi Ndërinstitucional. Kjo është një mundësi e rëndësishme për të parë nëse ka pasur një publikim të plotë nga qeveria për të ardhurat e industrisë nxjerrëse dhe publikim të të gjitha pagesave materiale ndaj qeverisë nga kompanitë e naftës, gazit dhe minierave sipas fushës së veprimit për të cilën është rënë dakord (kërkesa 4).

Hapi 7 – Rishikimi i projekt Raportit të EITI-it

Administratorit të Pavarur i jepet mandat për të kontaktuar subjektet raportuese në mënyrë që të sqarojë ndonjë mospërputhje në të dhënat e raportuara. Pastaj, Administratori i pavarur përgatit projekt Raportin. Grupi Ndërinstitucional këshillohet që të sigurojë që raporti:

- përshkruan metodologjinë e përdorur për publikimin dhe rakordimin e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të qeverisë dhe tregon zbatimin e standardeve profesionale ndërkombëtare;
- përfshin një përshkrim të secilit burim të ardhurash, përcaktimet e materialitetit dhe pragjet (kërkesa 4.1);
- përfshin një vlerësim nëse të gjitha kompanitë dhe subjektet qeveritare brenda fushës së veprimit të procesit të raportimit të EITI-it kanë dhënë informacionin e kërkuar (Kërkesa 5.3 (d));
- dokumenton nëse kompanive pjesëmarrëse dhe subjekteve të qeverisë i janë

kontrolluar deklaratat financiare gjatë vitit/viteve fiskalë të mbuluara nga Raporti i EITI-it;

- publikon plotësisht dhe rakordon informacionin e dhënë nga subjektet raportuese duke identifikuar ndonjë mospërputhje;
- përfshin një vlerësim nga Administratori i Pavarur rreth kuptueshmërisë dhe besueshmërisë të të dhënave të paraqitura, duke përfshirë një përmbledhje informuese të punës së kryer nga Administratori i Pavarur dhe ndonjë kufizim të vlerësimit të paraqitur;
- tregon mbulimin e ushtrimit të rakordimit.

Kur Raportet e mëparshme të EITI-it kanë rekomanduar veprime dhe reforma korrigjuese, Grupi Ndërinstitucional këshillohet të sigurojë që Administratori i Pavarur të komentojë rreth ecurisë së zbatimit të këtyre masave (Kërkesa 5.3 (e)). Nëse thuhet në termat e referencës, Grupi Ndërinstitucional duhet të marrë parasysh çdo rekomandim nga Administratori i Pavarur për forcimin e procedurave të raportimit në të ardhmen.

Hapi 8 – Miratimi dhe publikimi i Raportit të EITI-it

Grupi Ndërinstitucional duhet të vërtetojë raportin e EITI-it përpara se të publikohet. Në rastet kur Grupi Ndërinstitucional vendos të përfshijë komente shtesë nga palët kryesore në Raportin e EITI-it, autorësia e këtyre komenteve shtesë duhet të zbulohet qartësisht.

Hapi 9 – Nxitja dhe promovimi i debatit publik

Grupi Ndërinstitucional duhet të sigurohet që Raporti i EITI-it është i kuptueshëm, promovohet në mënyrë aktive, është i aksesueshëm publikisht dhe jep kontribut për debatin publik (kërkesa 6.1). Grupi Ndërinstitucional inkurajohet gjithashtu t'i bëjë Raportet e EITI-it të lexueshme nga pajisjet dhe t'u vendosë një kod Raporteve të EITI-it dhe dosjeve të të dhënave në mënyrë që informacioni të mund të krahasohet me të dhënat e tjera të disponueshme publikisht.

Hapi 10 – Rishikimi dhe raporti i veprimtarisë vjetore

Kërkesa 7.2 thotë që Grupi Ndërinstitucional i kërkohet të rishikojë rezultatet dhe ndikimin e zbatimit të EITI-it në administrimin e pasurive natyrore dhe të publikojë raporte vjetore të veprimtarisë (kërkesa 7.2 (a)). Objektivi i raportit të veprimtarisë është të komunikojë përpjekjet e ndërmarra për të arritur dhe mbajtur përputhshmërinë me kërkesat e EITI-it, përfshirë ecurinë në arritjen e objektivave të vendosur në planin e punës dhe për të dokumentuar ndikimin e EITI-it. Duhet gjithashtu të dokumentojë çdo rekomandim nga Administratori i Pavarur dhe nga Miratuesi (kur është e zbatueshme) dhe të përshkruajë veprimet e ndërmarra nga Grupi Ndërinstitucional për të vepruar në lidhje me këto rekomandime. Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it ofron një Udhëzim për raportet e veprimtarisë vjetore.

3. Orientim i mëtejshëm

Siç nënvizohet më lart, lexuesve u këshillohet t'i referohen Standardit të EITI-it për të verifikuar kërkesat e hollësishme që duhen përmbushur për të pasur përputhshmëri. (Standardi i EITI-it: http://EITI_org/document/standard)

Sekretariati ka nxjerrë gjithashtu një numër të madh udhëzimesh që mbulojnë shumë nga këto tema të përmendura më lart (Udhëzimet: http://EITI org/document/guidance-notes)

Udhëzimi 9 - dhjetor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org

Udhëzimi 9: Lista e kontrollit që sugjerohet për përcaktimin e fushës së veprimit të Raportimit të EITI-it

1. Përmbledhje

Në mënyrë që të jenë të dobishëm, Raportet e EITI-it duhet të bëhen në kohë, duhet të jenë të plotë, të besueshëm dhe të kuptueshëm. Një nga sfidat më të zakonshme që ka të bëjë me zbatimin e EITI-it është që Raporti i EITI-it të ofrojë një llogari të plotë të pagesave dhe të ardhurave. Një shqetësim përkatës është të tregohet se shifrat e Raportit të EITI-it janë të besueshme, domethënë janë të bazuara në një proces të besueshëm që zbaton standardet ndërkombëtare. Këto çështje janë kthyer shpesh në pengesë për të arritur përputhshmërinë. Prandaj, përcaktimi i fushës së veprimit të raportimit të EITI-it është një nga çështjet kryesore që Grupet Ndërinstitucionale duhet të marrin parasysh përpara hartimit të Raportit të EITI-it. Kjo përfshin përcaktimin se cilat burime të ardhurash do të mbulohen, cilat kompani dhe subjekte qeveritare duhet të marrin pjesë në procesin e raportimit, cilat garanci nevojiten për kompanitë dhe subjektet e qeverisë për të siguruar që të dhënat e dorëzuara janë të besueshme, etj. Ky udhëzim sugjeron një listë kontrolli të çështjeve që Grupi Ndërinstitucional mund të dëshirojë të marrë parasysh gjatë punës së tij. Ja vlen të theksohet se lista e kontrollit nuk ka për qëllim të jetë shteruese dhe Grupi Ndërinstitucional këshillohet të konsultohet me Standardin e EITI-it, si referenca përfundimtare në lidhje me kërkesat e EITI-it.

2. Informacion

Puna për fushën e veprimit ka për qëllim të identifikojë se çfarë duhet të mbulojë Raporti i EITI-it rreth burimeve të të ardhurave, kompanive dhe subjekteve të qeverisë që duhet të marrin pjesë në procesin e raportimit dhe përfshin gjithashtu punën që ndërmerret nga Grupi Ndërinstitucional (shpesh me ndihmën e një Sekretariati Kombëtar të EITI-it / konsulentëve të jashtëm) për të siguruar që raporti i EITI-it bëhet në kohë, është i plotë, i besueshëm dhe i kuptueshëm. Zakonisht çon drejt një "raporti për fushën e veprimit" i cili njofton punën që do të kryhet nga Administratori i Pavarur (firma e punësuar për të kryer rakordimin). Zakonisht përfshin shqyrtimin e çështjeve si periudha fiskale rreth të cilës duhet raportuar, informacionin kontekstual që duhet të jetë pjesë e Raportit të EITI-it, rishikimin e llojeve të garancive të nevojshme për të siguruar që të dhënat e paraqitura nga subjektet raportuese janë të besueshme, përcaktimin se cilat burime të ardhurash

nga nafta, gazi dhe minierat janë të rëndësishme, dhe, për pasojë, cilat kompani dhe subjekte të qeverisë duhet të raportojnë. Në disa raste, fusha e veprimit mund të hetojë disa çështje apo sfida me më hollësi me qëllim identifikimin e mundësive apo zgjidhjeve për t'u marrë parasysh nga Grupi Ndërinstitucional.

Shteteve zbatuese të EITI-it u kërkohet të marrin parasysh pyetjet rreth fushës së veprimit gjatë zhvillimit dhe rishikimit të planit të tyre të punës (Kërkesa 1.4-c-ii). Konsideratat e punës së hershme për fushën e veprimit, kanë rëndësi të veçantë për Kandidatët e rinj të EITI-it, të cilëve u kërkohet të publikojnë Raportin e parë EITI brenda 18 muajve nga momenti i marrjes së statusit kandidat. Një numër gjithnjë e më i madh shtetesh bëjnë studime të fushës së veprimit me këtë qëllim, Shtetet zbatuese të cilat kanë nxjerrë një apo disa Raporte të EITI-it, duhet gjithashtu të rishikojnë në mënyrë të rregullt fushën e veprimit të raportimit të EITI-it, në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në objektivat e planit të punës, strukturën e industrisë, regjimin fiskal dhe luhatjet e të ardhurave. Është e zakonshme rishikimi i fushës së veprimit në periudha vjetore, ne fillim të secilit cikël raportimi. Një punë tërësore për fushën e veprimit do t'i japë mundësinë Grupi Ndërinstitucional të bie dakord për terma të qarta reference për Administratorin e Pavarur. Një nga detyrat e para që do të ndërmarrë Administratori i Pavarur është rishikimi i fushës së veprimit për të cilën është rënë dakord nga Grupi Ndërinstitucional dhe të propozojë ndryshime nëse nevojiten. Kjo siguron që të ketë mirëkuptim të plotë ndërmjet Grupit Ndërinstitucional dhe Administratorit të Pavarur në lidhje me punën që duhet ndërmarrë nga secila palë për përgatitjen e Raportit të EITI-it. Si pjesë e punës për fushën e veprimit, Grupi Ndërinstitucional inkurajohet të rishikojë çdo mekanizëm ekzistues për publikimin në lidhje me informacionin kontekstual ose me informacionin rreth të ardhurave nga sektori, dhe të identifikojë nëse EITI mund të vazhdojë apo të forcojë këto sisteme në lidhje me raportimin e EITI-it.

3. Lista e kontrollit për përcaktimin e fushës së veprimit të raportimit të EITI-it

Lista e mëposhtme e kontrollit ka për qëllim të drejtojë grupet ndërinstitucionale drejt përcaktimit të fushës së veprimit të raportimit të EITI-it. Bërja e këtyre pyetjeve do të japë ndihmë që të sigurohet se Grupi Ndërinstitucional ka arritur një pozicion të rënë dakord rreth fushës së veprimit të raportit përpara se të angazhojë administratorin e pavarur dhe të zhvillojë shabllonet e raportimit. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet të dokumentojë procesin, në mënyrë që informacioni të jetë i disponueshëm gjatë miratimit. Grupet Ndërinstitucionale gjithashtu të publikojnë vendimet rreth fushës së veprimit në mënyrë që të rrisin ndërgjegjësimin dhe të angazhojnë palët jashtë Grupit Ndërinstitucional në këto diskutime.

Lidhja e fushës së veprimit të raportit të EITI-it me objektivat e planit të punës

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Rishikimin e objektivave dhe veprimtarive të parashtruara në planin e punës për t'u siguruar që fusha e veprimit të raporteve të EITI-it, të jetë në përputhje me objektivat e përgjithshëm të Grupit Ndërinstitucional?
- Marrjen parasysh të zgjerimit të hollësive dhe fushës së veprimit të raportit të EITI-it për çështje si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (3.7-3.8), shpenzime sociale diskrecionale (4.1.e), transferta vendore ad-hoc (4.2.e), pronësia përfituese (3.11) dhe kontratat (3.12)?

Afatet kohore

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Miratimin e periudhës fiskale që do të mbulojë raporti (kërkesa 2)?

Konteksti

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Rishikimin e kuadrit ligjor që udhëheq industritë nxjerrëse (kërkesa 3.2)?
- Zhvillimin e një ideje të mirë rreth burimeve dhe industrive nxjerrëse në vend dhe kontributin e tyre në ekonomi (kërkesa 3.3 dhe 3.4)?
- Identifikimin në kohë të burimeve të plota dhe të besueshme të informacionit rreth prodhimit dhe eksporteve (kërkesa 3.5)?
- Hetimin e rolit të secilës ndërmarrje shtetërore në sektorin e nxjerrjes, përfshirë marrëdhënien financiare me qeverinë, shpenzimet *quasi*-fiskale, pronësinë që ka qeveria ndaj kompanive të naftës, gazit dhe minierave (kërkesa 3.6)
- Marrjen parasysh të mënyrës se si të ardhurat e industrisë nxjerrëse, qofshin para apo pagesa në natyrë, regjistrohen në buxhetin kombëtar (kërkesa 3.7)?, dhe mundësitë për raportimin e menaxhimit të shpenzimeve dhe të ardhurave siç nxitet nga kërkesa 3.8?
- Hetimin e afateve kohore dhe plotësinë e informacionit të disponueshëm rreth mbajtësve të licencave dhe alokimet e licencave sipas kërkesës 3.9 dhe 3.10?
- Marrjen parasysh të fizibilitetit të publikimit të informacioneve rreth pronarëve përfitues të kompanive nxjerrëse që operojnë në vend (kërkesa 3.11)?
- Shqyrtimin e politikës së qeverisë rreth publikimit të kontratave dhe ka marrë parasysh transparencën e kontratave siç nxitet nga kërkesa 3.12?
- Përcaktimin e atyre që duhet të plotësojnë informacionin kontekstual që do të përfshihet në Raportin e EITI-it?

Plotësia

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Shqyrtimin e regjimit fiskal dhe burimeve të tjera të rëndësishme të të ardhurave që kanë të bëjnë me sektorin nxjerrës, duke iu referuar Kërkesës 4.1 të EITI-it, përfshirë të ardhurat nga shitja nga ana e qeverisë së pjesës së prodhimit apo nga nafta, gazi dhe mineralet e marra si pagesë në natyrë, pagesa sociale, pagesa tranzit, ofrime infrastrukturore apo marrëveshje të tjera mall me mall?
- Marrjen parasysh të transaksioneve ndërmjet subjekteve të qeverisë dhe kompanive shtetërore (kërkesa 4.2.c)?
- Identifikimin nëse subjektet e qeverisë vendore marrin pagesa direkte nga kompanitë (kërkesa 4.2.c) dhe nëse ekzistojnë transferta të detyruara apo ad-hoc ndërmjet nivelit kombëtar dhe vendor të qeverisjes (kërkesa 4.2.d)?
- Rishikimin e të dhënave ekzistuese nga periudha fiskale përkatëse për të përcaktuar materialitetin e këtyre burimeve të të ardhurave (kërkesa 4.1.a)?
- Përcaktimin e materialitetit që shpreh se cilat burime të ardhurash janë materiale dhe do të përfshihen në Raportin e EITI-it (kërkesa 4.1.a)
- Përcaktimin e pragjeve të pagesave dhe të të ardhurave kur është e nevojshme (kërkesa 4.1.a)?
- Identifikimin e kompanive nxjerrëse që bëjnë pagesa materiale brenda fushës së veprimit të burimeve materiale të të ardhurave (kërkesa 4.2)?
- Identifikimin e subjekteve qeveritare, përfshirë nivelet vendore, që mbledhin të ardhura materiale brenda fushës së veprimit të burimeve materiale të të ardhurave (kërkesa 4.2)?

Cilësia e të dhënave

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Hetimin e praktikave mbizotëruese të auditit për të dhënat e kompanive dhe të qeverisë (kërkesa 5.2.b)?
- Marrjen parasysh të llojeve të garancive që mund të jepen nga kompanitë dhe subjektet e qeverisë për të siguruar një proces të besueshëm raportimi (kërkesa 5.2.c)?

Vendimet konfirmuese për fushën e veprimit

A ka bërë Grupi Ndërinstitucional sa më poshtë?

- Rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, me qëllim identifikimin dhe heqjen e barrierave potenciale që pengojnë publikimin, në veçanti kur ka dispozita rreth konfidencialitetit në kontrata apo legjislacion (kërkesa 4.1.c.iii)?
- Dokumentimin e qëndrimeve të rëna dakort nga Grupi Ndërinstitucional rreth konsideratave për fushën e veprimit (kërkesa 1.3.g.iii). përfshirë për shembull përmbledhjet që mund të bëhen të disponueshme publikisht dhe të përfshihen në Raportin e EITI-it?
- Reflektimin e fushës së veprimit në Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur?

2. Orientim i mëtejshëm

Sekretariati ka nxjerrë udhëzime që mbulojnë shumë nga këto tema, duke përfshirë termat standarde të referencës për studime të fushës së veprimit. Këto Terma Reference mund të jenë të dobishme si për grupet ndërinstitucionale që dëshirojnë ta ndërmarrin vetë këtë punë dhe për angazhimin e palëve të treta për ndihmë rreth procesit të fushës së veprimit. Sekretariati Ndërkombëtar gjithashtu vë në dispozicion shembuj të studimeve të fushës së veprimit.

- Standardi i EITI-it, në veçanti Kërkesat 3, 4 dhe 5: http://EITI NTIN.org/document/standard
- Udhëzimet: http://EITI.org/document/guidance-notes
- Termat Standarde të Referencës për studimet e fushës së veprimit: http://EITI.org/document/guidance-notes

Udhëzimi 10 – dhjetor 2013

*K*y udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it . Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org.

Udhëzimi 10: Raportimi nënkombëtar

Kërkesa 4.2(d) dhe (e)

1. Përmbledhje

Në disa vende, kompanitë u bëjnë pagesa direkte niveleve nën-kombëtare të qeverisë (p.sh. qeverive rajonale, bashkive dhe kryepleqësive). Përveç kësaj, disa qeveri kanë edhe mekanizma formalë ose informalë për ndarjen e të ardhurave që parashikojnë që një pjesë e të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga sektori i nxjerrjes t'i shkojë njësive të nivelit nën-kombëtar. Këto pagesa dhe kalime janë shpesh me shumë interes për palët e interesuara, sidomos në diskutimet lidhur me përfitimet që u akumulohen komuniteteve lokale, edhe nëse këto pagesa mund të përfaqësojnë vetëm një pjesë të të gjitha të ardhurave në nivel kombëtar. Të ardhurat që mbahen në nivel lokal ose transfertat e detyrueshme të të ardhurave, janë shpesh burime të rëndësishme të ardhurash për qeveritë lokale. Transparenca e këtyre pagesave dhe transfertave mund të jetë e dobishme për të parë nëse janë bërë vërtet transferta dhe për të vënë autoritetet lokale para përgjegjësisë.

Ky udhëzim orienton Grupet Ndërinstitucionale dhe administratorët e pavarur lidhur me adresimin e këtyre çështjeve në përputhje me standardin EITI. Ai ka dy pjesë. Pjesa 1 ofron orientime lidhur me pagesat direkte që kompanitë u bëjnë subjekteve nën-kombëtare. Standardi EITI kërkon që, pagesat direkte të kompanive për entet qeveritare nën-kombëtare dhe marrja e këtyre pagesave të bëhen të ditura për publikun dhe të përfshihen në Raportin EITI (Kërkesa 4.2(d)). Pjesa 2 ofron orientime lidhur me transfertat e të ardhurave nga industritë nxjerrëse mes qeverive qendrore dhe lokale. Në rastet kur transfertat midis njësive qeveritare kombëtare dhe atyre nën-kombëtare janë të detyrueshme me një kushtetutë kombëtare, statut apo mekanizma të tjerë të ndarjes së të ardhurave, transfertat materiale mundtë bëhen të ditura në Raportin EITI (kërkesa 4.2(e)). Kërkesat e detajuara përcaktohen në kutinë 1, më poshtë.

Kutia 1 – Mbulimi i raportimit nën-kombëtar në Standardin EITI

Kërkesa 4.2 – Përcaktimi i kompanive dhe njësive qeveritare që janë të detyruara të raportojnë.

d) **Pagesat nën-kombëtare**: Grupet Ndërinstitucionale duhet të vendosin nëse pagesat direkte, brenda objektit të linjave të miratuara të përfitimeve, nga kompanitë te njësitë qeveritare nën-kombëtare, duhet të jenë materiale apo jo. Në rastet kur ato janë materiale, Grupi Ndërinstitucional duhet të garantojë që pagesat e kompanive për njësitë qeveritare nën-kombëtare dhe marrja e këtyre pagesave të bëhen të ditura e të përfshihen në Raportin EITI.

e) **Transfertat nën-kombëtare**: Kur transfertat midis njësive qeveritare kombëtare dhe nën-kombëtare lidhen me të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse dhe janë të detyrueshme në bazë të një kushtetute kombëtare, statutit apo mekanizmave të tjerë për ndarjen e të ardhurave, Grupi Ndërinstitucional duhet të garantojë që transfertat materiale të bëhen të ditura në raportet EITI. Raporti EITI duhet të bëjë të ditur formulën e ndarjes së të ardhurave, nëse ekziston një e tillë, si dhe çdo mospërputhje midis shumës së transfertës së llogaritur në përputhje me formulën përkatëse të ndarjes së të ardhurave dhe shumës faktike të transferuar nga qeveria qendrore çdo njësie përkatëse nën-kombëtare. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet që t'i rakordojë këto transferta. Grupi Ndërinstitucional inkurajohet që të garantojë që çdo material diskrecionar ose transfertë e posaçme të bëhet e ditur dhe, kur është e mundur, të rakordohet në Raportin EITI. Në rastet kur ka pengesa kushtetuese apo pengesa të konsiderueshme praktike për pjesëmarrjen e njësive qeveritare nën-kombëtare, Grupi Ndërinstitucional mund të përpiqet që ta përshtasë zbatimin e nismës me Kërkesën 1.5.

2. Udhëzim

Pjesa I: Adresimi i pagesave nga kompanitë te njësitë qeveritare nën-kombëtare

Sekretariati rekomandon një proces 3-hapësh për adresimin e pagesave nga kompanitë te njësitë qeveritare nën-kombëtare (shih Figurën 1).

Figura 1 – Adresimi i pagesave nën-kombëtare



Hapi 1 – Identifikimi i pagesave direkte nga kompanitë te qeveritë nën-kombëtare

Grupi Ndërinstitucional këshillohet të bëjë një analizim dhe të kuptojë:

- Çfarë taksash, tarifash dhe pagesash të tjera duhet t'i bëjnë kompanitë niveleve nën-kombëtare të qeverisë. Linjat tipike të përfitimeve përfshijnë taksat mbi pronat, tarifat për sipërfaqe/tokë, tarifat për përdorimin e ujit dhe burimeve të tjera. Këto pagesa mund të jenë të detyrueshme me kushtetutë, të detyrueshme nga legjislacioni apo rregulloret kombëtare dhe lokale, ose të jenë të përcaktuara në licencë apo kontratë.
- Cilat njësi nën-kombëtare i marrin këto pagesa (p.sh. qarqet, shtetet, bashkitë, këshillat e rretheve, kryepleqësitë apo asambletë rajonale)?
- A i mbledhin këto njësi pagesat në mënyrë direkte apo përmes një agjencie tjetër në nivel kombëtar/federal apo ndonjë nivel tjetër nën-kombëtar?

Në rastet ku u bëjnë pagesa direkte qeverive nën-kombëtare, Grupi Ndërinstitucional duhet të vlerësojë materialitetin e këtyre pagesave në raport me të ardhurat totale të qeverisë dhe t'i krahasojë me të ardhurat totale të marra nga njësitë nën-kombëtare (shih hapin 2). Nëse Grupi Ndërinstitucional konstaton se nuk ka pasur pagesa të tilla, ky vlerësim duhet të dokumentohet. Mund të jetë me vlerë edhe paraqitja e një përmbledhjeje në Raportin EITI për të qartësuar se pse nuk janë adresuar pagesat nga kompanitë tek njësitë nën-kombëtare.

Hapi 2 – Vlerësimi i materialitetit të pagesave direkte nga kompanitë te njësitë nën-kombëtare

Në rastet kur Grupi Ndërinstitucional vendos se ka pagesa direkte nga kompanitë te qeveritë nën-kombëtare, Grupi Ndërinstitucional duhet të vlerësojë materialitetin e këtyre pagesave. Ky proces duhet të udhëhiqet nga qasja e përgjithshme përcaktuar në kërkesën 4.1(a):

Para procesit të raportimit, Grupi Ndërinstitucional duhet të bjerë dakord mbi llojet e pagesave dhe të ardhurave janë materiale e që duhen për këtë arsye të bëhen të ditura, duke përfshirë edhe përkufizimet dhe vlerat kufi të materialitetit. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen materiale, nëse mosbërja e tyre apo deklarimi i gabuar i tyre do të ndikonte ndjeshëm në natyrën gjithëpërfshirëse të Raportit EITI. Në Raportin EITI duhet të ketë një përshkrim të çdo linje të ardhurash, një përkufizim të materialitetit që lidhet me të dhe vlerat kufi. Në përcaktimin e përkufizimeve dhe vlerave kufi të materialitetit, GRUPI NDËRINSTITUCIONAL duhet të marrë parasysh sasinë e të ardhurave krahasuar me totalin e të ardhurave. GRUPI NDËRINSTITUCIONAL duhet të dokumentojë opsionet e marra në konsideratë dhe argumentimin për vendosjen e përkufizimeve dhe vlerave kufi.

Në disa raste, të dhënat që nevojiten për bërjen e këtij vlerësimi mund të jenë bërë publike që më përpara nga kompanitë, autoritetet e qeverive nën-kombëtare apo burime të tjera. Në raste të tjera, mund të jetë e mundur vetëm përllogaritja e shumës së pagesave përmes konsultimeve me aktorët e interesuar.

Në rastet kur GRUPI NDËRINSTITUCIONAL vendos se pagesat nga kompanitë drejt njësive nën-kombëtare janë materiale, këto pagesa dhe të ardhura, duhet të bëhen të ditura dhe të përfshihen në Raportin EITI. Në rastet kur GRUPI NDËRINSTITUCIONAL vendos se pagesat nga kompanitë drejt njësive nën -kombëtare nuk janë materiale, baza e këtij vlerësimi duhet të dokumentohet. Mund të jetë e dobishme edhe përfshirja e një përmbledhjeje për këtë në Raportin EITI.

Hapi 3 – Publikimi dhe rakordimi i pagesave direkte nga kompanitë te njësitë nën-kombëtare

Në rastet kur GRUPI NDËRINSTITUCIONAL vendos se pagesat nga kompanitë të njësitë nën-kombëtare janë materiale, këto pagesa dhe të ardhura duhet të bëhen të ditura publikisht dhe duhet të rakordohen në Raportin EITI. Mund të jetë e dobishme edhe përfshirja e një përmbledhjeje në Raportin EITI. Rezultatet e hetimit të Grupit Ndërinstitucional (dhe referencat në materialet mbështetëse) duhet të pasqyrohen në termat e referencës për Administratorin e Pavarur. Administratori i Pavarur duhet:

- Të rishikojë vlerësimin e Grupit Ndërinstitucional për materialitetin e pagesave direkte nga kompanitë te njësitë nën-kombëtare;
- Aty ku është e mundur, të rishikojë propozimin e Grupit Ndërinstitucional në lidhje me vlerën kufi të materialitetit dhe njësive duhet t'u kërkohet që të raportojnë;
- Të propozojë modele raportimi për kompanitë dhe qeverinë dhe siguritë që ato duhet të përmbajnë;
- Të mbledhë e të rakordojë të dhëna dhe t'i paraqesë konstatimet e tij në raportin e Administratorit të Pavarur.

Një sfidë e veçantë ka të bëjë me sigurimin e pjesëmarrjes së të gjitha agjencive qeveritare nën-kombëtare në këtë proces. Kjo mund të kërkojë një komunikim shtesë (duke përfshirë edhe komunikim nga vetë qeveria qendrore), trajnim dhe ndërtim kapacitetesh.

2. Shembuj

Kutia 2 – Taksa specifike e industrive nxjerrëse që i paguhet qeverisë vendore në Sierra Leone

Revenue Stream	Extractive Industry	Frequency of Payment	Agency Responsible for collection	Application of payment.
Reconnaissance Licence	Mining	Annual	MMMR/NRA	Consolidated Fund
Exploration Licence	Mining	Annual	MMMR/NRA	Consolidated Fund
Mining Licence	Mining	Annual	MMMR/NRA	Consolidated Fund
Surface Rent	Large/Small Scale Mining	Annual	Chiefdom/District Council/Individuals	Disbursed according to formula.
Royalty	Mining	As stipulated in Agreement.	NRA	Consolidated Fund
Corporate tax	Mining	Annual(Depends on contract)	NRA	Consolidated Fund
Agricultural Development Fund	Mining	Annual	MMMR	Mining Community for Agriculture Development
Training fees	Petroleum	Annual	Petroleum Directorate	Petroleum Directorate
Surface Rental	Petroleum	Annual	Petroleum Directorate	Petroleum Directorate
Sale of geophysical data	Petroleum	Upon request	Petroleum Directorate	Petroleum Directorate
Petroleum (Exploration)Licence	Petroleum	Annual	Petroleum Directorate	Petroleum Directorate
Diamond Exporter's licence	Mining Exports	Annual	NRA	Consolidated Fund
Diamond Exporter' Agent fees	Mining Exports	Annual	NRA	Consolidated Fund

Source: SLEITI - http://www.sleiti.gov.sl/UserFiles/downloads/SIERRA%20LEONE-%202ND%20RECONCILIATION%20REPORT-FINAL%20LAMIN%20BOA.pdf

Box 3 – Extract from recommendations of the independent administrator in Sierra Leone 2008-2010 EITI Report

11.6 Qiraja për Sipërfaqe

Konstatim:

Akti i Minierave dhe Mineraleve i vitit 2009, paragrafi 35, parashikon që pronarit të tokës t'i paguhet një kompensim ose një qira sipërfaqeje: Aktualisht, shumat që paguhen përcaktohen nga negociatat mes pronarëve tokës dhe kompanisë përkatëse.

Rakordimi është i vështirë pasi të dhënat nuk mbahen siç duhet nga Këshillat e Rretheve dhe Administrata e Pleqësive, kurse pagesat ndonjëherë bëhen me para në dorë.

11.6.1 Rekomandim:

Pagesat dhe mbledhja e tyre mund të kanalizohen në një linjë për të garantuar standartizim dhe transparencë. Kostoja për kilometër katror mund të përcaktohet në kontratat e qirasë së minierave dhe t'i paguhet një burimi të vetëm. Kjo duhet të zbatohet për toka që janë në pronësi të komunitetit, p.sh. kryepleqësitë. Për shembull, një person në Këshillin e Rrethit mund të ngarkohet me detyrën e marrjes së pagesave nga kompanitë.

Kjo do të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Për t'u siguruar që pagesat në terma realë mbeten të pandryshueshëm, kostoja për kilometër katror mund të indeksohet në bazë të inflacionit.

Kutia 4 – Taksat specifike të industrisë jo-nxjerrëse në Nigeri i paguhen qeverisë vendore

Raportet EITI të Nigerisë përfshijnë përfitimet, si ato specifike, ashtu edhe ato jospecifike për sektorin nxjerrës. Kontributet për Komisionin e Zhvillimit të Deltës (KZHDN) Nigeriane që janë paguar nga kompanitë janë rakorduar, ndërsa taksa *Withholding and Pay as you earn* (PAYE), një taksë mbi pagat, janë taksa që u paguhen shteteve nga kompanitë e që nuk janë specifike për kompanitë nxjerrëse dhe nuk konsiderohen të konsiderueshme dhe si të tilla bëhen publike, por nuk rakordohen.

8.1.7 Kontributet në KZHDN

Akti i KZHDN-së i detyron të gjitha kompanitë që operojnë në rrjedhën e sipërme të lumit që t'i japin 3% të buxheteve të tyre vjetore Komisionit për Zhvillimin e Deltës Nigeriane (KZHDN). Shuma e pagueshme është si në Naira, ashtu edhe në Dollarë Amerikanë. Rakordimi i parë i kontributeve të kryer midis të dhënave të KZHDN-së dhe të dhënave të kompanive, së bashku me rregullimet e bëra, si rezultat i rakordimit dhe të gjithë diferencave të pazgjidhura, paraqitet në Tabelën 8.13.

Tabela 8-13 – Përmbledhje e Rakordimit të Kontributeve të KZHDN-së (në dollarë)

NDDC Dollar	Initial Templates			Adjustments		Adjusted Figures		
	Govt	Company	Difference	Govt	Company	Govt	Company	Unresolved Difference
	$'000	$'000	$'000	$'000	$'000	$'000	$'000	$'000
2009	238,860	219,305	19,555	39,574	31,453	278,434	250,758	27,676
2010	315,950	427,726	(111,775)	80,464	(60,682)	396,414	367,044	29,371
2011	507,868	429,580	78,288	(1,171)	68,479	506,698	498,059	8,639
Total	**1,062,679**	**1,076,611**	**(13,932)**	**118,868**	**39,250**	**1,181,546**	**1,115,861**	**65,685**

Shpjegimi i diferencave të pazgjidhura në Dollarë. Kontributet për KZHDN-në janë si më poshtë:

Tabela 8-25 – Përmbledhja vjetore e Derdhjeve të Pakuadruara të Shteteve

	Flows to State			Plus Conversion
2009	US$'000	£'000	N'000	US$'000
WHT	3,092	4	1,128,156	10,544.04
PAYE	97,731	0	56,670,731	471,757.82

Kutia 5 – Shembull i një formulari raportimi nënkombëtar në Mongoli

Annex 1. EITI Subnational Reporting Templates: Mongolia

Approved by joint order # 01/12/13 of Chairman of National Statistical Committee and Minister for Finance dated 2011/01/26

EITITEMPLATE-4

The report of year ..... on taxes and fees collected in local budget from minerals and petroleum extracting and exploring company

A. CONTACT ADDRESS

Registration number				
Company name				
Location		Name	Code	
Aimag, city				
Soum, district				
Type of entity				
Type of owning				

1. Aimag's and capital city's government office should submit the report to Mongolian Tax Administration (MTA) before February 15.
2. MTA should consolidate the report and submit to Accounting policy department of Ministry of Finance no later than March 15.
3. Ministry of Finance should check reports and send it to EITI Secretariat no later than April 15.

B. BASIC INFORMATION

1. Taxes, payments, fees and dividends collected in local budget

Types		Amount /000 MNT/
1.1 Taxes collected		
1.1.1	Real estate tax	
1.1.2	Tax on vehicles and self-moving mechanisms	
1.1.3	Others	

Për të marrë formularin e plotë, shihni Shtojcën 1 tek "Zbatimi i EITI-it në Nivel Nënkombëtar" – (Banka Botërore, 2011)

Pjesa II: Adresimi i transfertave midis qeverisë kombëtare dhe njësive të qeverisë nënkombëtare

Sekretariati rekomandon një proces 6-hapësh për adresimin e transfertave midis njësive të qeverisë (shih Figurën 2).

Figura 2 – Adresimi i transfertave nënkombëtare

Hapi 1 – A ka transferta materiale të ardhurash që lidhen me burimet midis njësive të qeverisë kombëtare dhe asaj nënkombëtare?

Jo – Grupi Ndërinstitucional duhet të dokumentojë qasjen dhe konstatimet e tij. Mund të jetë e dobishme që edhe në raportin EITI të përfshihet një përmbledhje.

Hapi 2 – A janë këto transferta të detyrueshme nga kushtetuta e vendit, statuti apo mekanizma të tjerë për ndarjen e të ardhurave?

Hapi 3 – Përcaktimi i një procedure raportimi që bën të njohura këto pagesa, duke vënë në dukje çdo shmangie nga formula e miratuar e ndarjes së të ardhurave. Inkurajohet përdorimi i një procedure rakordimi.

Hapi 4 – A ka ndonjë transfertë diskrecionare apo të posaçme?

Hapi 5 – Grupet Ndërinstitucionale inkurajohen (por nuk detyrohen) që të përcaktojnë një procedurë raportimi që bën të ditura këto transferta. Inkurajohet, gjithashtu, edhe procedura e rakordimit.

Hapi 6 – Garantimi i reflektimit të konstatimeve në termat e referencës për Administratorin e Pavarur.

Hapi 1 – Vendosja e transfertave të detyrueshme me kushtetutë kombëtare, statut ose mekanizma të tjerë për ndarjen e të ardhurave

Për të identifikuar nëse ka ndonjë transfertë midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare që mblidhen nga industritë nxjerrëse dhe që janë të detyrueshme nga kushtetuta e vendit, ndonjë statut apo mekanizma të tjerë për ndarjen e të ardhurave, Grupi Ndërinstitucional mund të konsiderojë të vlefshme sa më poshtë:

- Nëse ka ndonjë ligj, rregullore apo marrëveshje që i detyron transfertat e të ardhurave që lidhen me burimet nga qeveria kombëtare ose federale në njësi specifike (p.sh. në zonat prodhuese).
- Nëse po, a ka një formulë apo procedurë të miratuar që përcakton shumën dhe kohën e transfertave?
- Cila njësi e qeverisë është përgjegjëse për llogaritjen, transferimin dhe mbledhjen e këtyre të ardhurave?

Aty ku transfertat nuk janë të detyrueshme, por kryhen herë pas here, Grupi Ndërinstitucional inkurajohet që t'i bëjë të ditura dhe, ku është e mundur, t'i rakordojë këto transferta. Për më shumë informacion, shihni hapin 4 më poshtë.

Hapi 2 – Vlerësimi i materialitetit të transfertave që lidhen me industrinë nxjerrëse midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare.

Në rastet kur Grupi Ndërinstitucional konstaton se ka transferta midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare që vijnë nga të ardhurat nga industritë nxjerrëse, Grupi Ndërinstitucional duhet të vazhdojë të bëjë studime të tjera për të përcaktuar materialitetin e këtyre transfertave.

Ashtu si me pagesat dhe të ardhurat, qasja e përgjithshme e përcaktuar në kërkesën 4.1(a) duhet ta informojë këtë proces:

Para procesit të raportimit, Grupi Ndërinstitucional duhet të përcaktojë se cilat pagesa dhe të ardhura janë materiale dhe që duhen bërë të ditura, duke përfshirë përkufizimet dhe kufijtë e përshtatshëm të materialitetit. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen materiale nëse mosdeklarimi apo deklarimi i gabuar i tyre mund të ndikojnë ndjeshëm në plotësinë e Raportit EITI. Përshkrimi i çdo linje të ardhurash dhe përkufizimet e kufijtë e materialitetit që lidhen me të, duhet të jenë pjesë e Raportit EITI. Për përcaktimin e përkufizimeve dhe kufijve të materialitetit, Grupi Ndërinstitucional duhet të shohë madhësinë e linjave të të ardhurave krahasuar me totalin e të ardhurave. Grupi Ndërinstitucional duhet t'i dokumentojë opsionet e shqyrtuara dhe argumentimin e përcaktimit të përkufizimeve dhe kufijve.

Në disa raste, të dhënat që nevojiten për të bërë këtë vlerësim janë publikuar me kohë (nga autoritetet qeveritare ose burime të tjera). Në raste të tjera, vlerësimi i madhësisë së transfertave mund të bëhet vetëm përmes konsultimeve me aktorët e interesuar.

Në rastet kur Grupi Ndërinstitucional vlerëson se transfertat midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare që lidhen me të ardhurat nga industritë nxjerrëse janë materiale, këto transferta duhet të bëhen të ditura në Raportet EITI. Aty ku Grupi Ndërinstitucional konstaton se transfertat midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare që vijnë si rezultat i të ardhurave nga industritë nxjerrëse nuk janë materiale, baza e këtij vlerësimi duhet të dokumentohet. Mund të jetë e dobishme që në Raportin EITI të përfshihet edhe një përmbledhje për këtë.

Hapi 3 – Përcaktimi i një procedure raportimi për bërjen të ditur të transfertave të detyrueshme

Grupi Ndërinstitucional duhet të përcaktojë një procedurë raportimi për bërjen publike të transfertave të detyrueshme midis njësive të qeverisë kombëtare dhe atyre nënkombëtare që janë materiale, duke nxjerrë në pah çdo shmangie nga formula e miratuar e ndarjes së të ardhurave. Inkurajohet përdorimi i një procedure rakordimi. Nëse palët bien dakord, rakordimi mund të ndjekë të njëjtët hapa të sugjeruar për rakordimin e pagesave direkte nga kompanitë tek njësitë nënkombëtare.

Raporti EITI duhet të bëjë të ditur formulën e ndarjes së të ardhurave, nëse ekziston një e tillë, si dhe mospërputhjet midis shumës së transfertës; llogaritur sipas formulës përkatëse të ndarjes së të ardhurave dhe shumës faktike që është transferuar midis qeverisë qendrore dhe çdo njësie relevante nënkombëtare.

Hapi 4 – Adresimi i transfertave diskrecionare ose të posaçme

Grupi Ndërinstitucional inkurajohet që të miratojë një procedurë raportimi që bën publike transferta diskrecionare ose ad-hoc të ardhurash që lidhen me burimet, duke e përfshirë këtë punë në termat e referencës për Administratorin e Pavarur. Inkurajohet miratimi i një procedure rakordimi. Grupi Ndërinstitucional duhet ta dokumentojë qasjen e ndjekur në adresimin e transfertave nënkombëtare. Mund të jetë e dobishme edhe përfshirja e një përmbledhjeje në Raportin EITI.

3 Raste Studimi

Kutia 6 – Raste studimi nga Madagaskari dhe Peruja

Peru

Raporti EITI i vitit 2010 tregon se 34% të totalit të të ardhurave nga sektorët e minierave dhe naftës u transferohen automatikisht qeverive nënkombëtare në Peru. Kontribuesi më i madh është sektori i minierave që rrjedh nga taksa e korporatës që paguajnë kompanitë nxjerrëse. 50% e taksës së korporatës që mblidhet u shkon direkt njësive të qeverisë vendore sipas kësaj shpërndarjeje: 10%, 25% dhe 40% bashkive, provincave dhe departamenteve ku ushtrohet aktiviteti nxjerrës dhe 25% qeverive rajonale. Një formulë e ngjashme aplikohet edhe për rentat minerare. Nga ana tjetër, rentat e hidrokarbureve shpërndahen sipas një procedure të krahasueshme nga e cila përfitojnë kryesisht qeveritë

rajonale (për naftën) dhe bashkitë (për gazin). Raportet EITI të Perusë përmbajnë një shpjegim të hollësishëm të këtij regjimi.

Raportet EITI rakordojnë shifrat e llogaritura për sektorin e minierave marrë nga publikimi i taksës së korporatës dhe formulat e zbatuara me shifrat e vendosura nga agjencia qeveritare e ngarkuar me administrimin e këtyre transfertave (Zyra e Kryeministrit). Krahasime të ngjashme përfshihen për shpërndarjen e rentave minerare midis rentave të publikuara të detajuara (sipas rajonit) dhe shifrave të transferuara në përputhje me Zyrën e Kryeministrit. Për shpërndarjen e rentave të naftës, raportet rakordojnë edhe shifrat e publikuara nga kompanitë me shifrat e llogaritura nga autoritetet. Në rastin e rentave të gazit, rakordohet edhe shpërndarja në Departamentin e Cusco-s, përfituesi i vetëm i rentave të gazit, midis kompanive që marrin pjesë në rakordim dhe agjencisë që i mbledh, Perupetro.

Këto rakordime në Raportin EITI shfaqën diferenca të papërfillshme në rastin e shpërndarjes së rentave së gazit, mospërputhje të vogla në rastin e sektorit të minierave, por diferenca të konsiderueshme në rastin e rentave minerare.

Madagaskar

Zyra kombëtare e kadastrës ("Bureau des Cadastrres Miniers") mbledh një tarifë administrimi ("Frais d'administration miniere"), e cila u shpërndahet më pas njësive të qeverisë vendore (sipas një formule të paracaktuar, përafërsisht 24% e totalit të tarifave të mbledhura i shkon qeverisë vendore). Raporti EITI për vitin 2010, i publikuar në shtator 2011 tregoi se të ardhurat e mbledhura në emër të komuniteteve lokale në nivel qendror nuk u ishin transferuar përfituesve për të cilët ishin destinuar. Raporti hodhi dritë mbi çështjet kryesore që pengojnë komunitetet lokale në mbledhjen e këtyre të ardhurave. Pas publikimit të raportit, kryetarët e njësive të qeverisë vendore të përfshira në aktivitetin e minierave protestuan zyrtarisht duke iu drejtuar ministrit të linjës, duke kërkuar që t'u paguheshin këto të ardhura. Kjo çoi në një debat të rëndësishëm[6] dhe hetimet e mëtejshme evidentuan tre deri në katër vjet të ardhura të papaguara bashkive. Gjithashtu, raporti tregoi se disa transferta u ishin bërë zyrtarëve vendorë në llogaritë e tyre personale, pasi shumë bashki nuk kishin llogari bankare. Ky debat ka çuar në reforma të rëndësishme, por çështja mbetet ende sfiduese. Raporti EITI i vitit 2011 adreson pagesat nënkombëtare më në hollësi.

Shembuj

Kutia 7 – Transfertat e detyrueshme në Peru: Shpërndarja e rentave dhe sektori minerar

Rentat në sektorët e minierave, naftës dhe gazit mblidhen nga një autoritet kombëtar dhe një pjesë e tyre u kalon autoriteteve vendore (për çdo sektor përdoret një mekanizëm i posaçëm shpërndarjeje). Përveç kësaj, Sektori Minerar është pjesa (aktualisht 50%) e taksës totale të korporatës mbledhur nga industritë nxjerrëse që i transferohet automatikisht qeverisë vendore dhe universiteteve lokale.

[6] Shih: http://www.eiti-madagascar.org/fr/content/frais-dadministration-mini%C3%A8re-d%C3%A9faillance-du-syst%C3%A8me-de-reversement dhe http://lexpressmada.com/revenu-minier-madagascar/46656-des-regions-et-des-communes-non-payees.html



Burimi: Raporti EITI i Perusë për 2004-2007

Kutia 9 – Formula për shpërndarjen e sektorit minerar në Peru

Shpërndarja e 100 *soles* (monedha vendase) e sektorit minerar

Departament	Province	District	Population	FBI	Population *FBI	District Municipality	Provincial Municipalities	Departamental Municipalities	Regional Government	Total Distributed
Departament (A)	Province (AA)	District (AAA)	10	50%	5.0	S/. 10.00	S/. 10.33	S/. 11.05		S/. 31.38
		District (AAB)	5	80%	4.0		S/. 8.26	S/. 8.84		S/. 17.10
		District (AAC)	2	50%	1.0		S/. 2.07	S/. 2.21		S/. 4.28
		District (AAD)	3	70%	2.1		S/. 4.34	S/. 4.64		S/. 8.98
	Province (AB)	District (ABA)	5	80%	4.0			S/. 8.84		S/. 8.84
	Province (AC)	District (ACA)	4	50%	2.0			S/. 4.42		S/. 4.42
Regional Government (A)									S/. 25.00	S/. 25.00
Total ABC Company Canon						S/. 10.00	S/. 25.00	S/. 40.00	S/. 25.00	S/. 100.00

Legal base in place for the periods included in this Study

Income Tax -

- D. S. N° 179-2004-EF, Texto Único Ordenado
- D. S. Nº 122-94-EF y modificatorias, Reglamento del TUO.

Mining Canon -

- Ley Nº 27506 (published on July 10.,2001).
- Regulated by D.S. Nº 005-2002-EF (published on January 09, 2002).
- D.S. N°003 -2003 - EF that modifies D.S. N°005-200 2-EF- Reglamento de la Ley de Canon (published on January 09, 2003).
- D.S. N°115 -2003-EF, modifying D.S. N°005-2002-EF which approved the Reglamento de la Ley de Canon (published on August 14, 2003).
- Ley N°28077 – Modification of Ley N°27506 -Ley de Canon (published on September 26, 2003)
- D.S. N°029 -2004-EF, modifying D.S. N°005-2002-EF, by which the Reglamento de la Ley N°27506, Ley del Canon was approved (published on February 17, 2004).
- Ley N°28322 – Modification of Articles Ley N°275 06, Ley de Canon, modified by Ley Nº 28077 (published on August 10, 2004)
- D.S. N°187 -2004-EF, modifying D.S. N°005-2002-EF, through which the Regulations for Ley N°27506, Ley del Canon were approved (publishe d on December 22, 2004).

Burimi: Raporti EITI i Perusë 2008-2010

Kutia 10 – Mospërputhjet në rentat minerare transferuar qeverive rajonale në Peru (2010)

Tabela 10.1 – Transfertat e llogaritura në raportin e rakordimit sipas formulës (A) dhe shifrat faktike transferuar autoriteteve përkatëse (B).

(A)

Figures Determined for the Reconciliation Study			
Mining royalty beneficiary departments	Local governments of the department (1)	Regional governments	Regional Universities
	80%	15%	5%
Ancash	103,280	19,365	6,455
Apurimac	41,304,684	7,744,628	2,581,543
Arequipa	13,888,210	2,604,039	868,013
Ayacucho	57,197,955	10,724,617	3,574,872
Cajamarca	28,674,608	5,376,489	1,792,163
Huancavelica	6,528,706	1,224,132	408,044
Huánuco	1,713,331	321,250	107,083
Junín	29,470,140	5,525,651	1,841,884
La Libertad	18,642,427	3,495,455	1,165,152
Lima	22,575,757	4,232,954	1,410,985
Moquegua	76,495,253	14,342,860	4,780,953
Pasco	32,877,877	6,164,602	2,054,867
Puno	49,708,936	9,320,426	3,106,809
Tacna	72,577,542	13,608,289	4,536,096
	(3) 451,758,706	(3) 84,704,757	(3) 28,234,919

(B)

Official Figures - PCM			
Mining royalty beneficiary departments	Local governments of the department (1)	Regional governments	Regional Universities
	80%	15%	5%
Ancash	4,570,163	856,905	285,635
Apurímac	43,783,214	8,209,353	2,736,451
Arequipa	14,776,153	2,785,709	923,510
Ayacucho	58,652,594	10,997,361	3,665,787
Cajamarca	29,423,734	5,516,950	1,838,983
Huancavelica	11,119,147	2,109,462	694,947
Huánuco	1,709,000	321,547	106,812
Junín	34,932,320	6,549,810	2,183,270
La Libertad	40,526,314	7,598,684	2,532,895
Lima	38,458,966	7,032,283	2,403,685
Moquegua	84,108,024	15,770,255	5,256,752
Pasco	47,984,824	9,155,282	2,999,051
Puno	59,613,392	11,177,511	3,725,837
Tacna	72,577,542	13,608,289	4,536,096
	542,235,387	101,689,401	33,889,711

Tabela 10.2 – Mospërputhjet (A-B)

Differences			
Mining royalty beneficiary departments	Local governments of the department (1)	Regional governments	Regional Universities
	80%	15%	5%
Ancash	4,466,883	837,540	279,180
Apurímac	2,478,530	464,725	154,908
Arequipa	887,943	181,670	55,497
Ayacucho	1,454,639	272,744	90,915
Cajamarca	749,126	140,461	46,820
Huancavelica	4,590,441	885,330	286,903
Huánuco	-4,331	297	-271
Junín	5,462,180	1,024,159	341,386
La Libertad	21,883,887	4,103,229	1,367,743
Lima	15,883,209	2,799,329	992,700
Moquegua	7,612,771	1,427,395	475,799
Pasco	15,106,947	2,990,680	944,184
Puno	9,904,456	1,857,085	619,028
Tacna	-	-	-
	90,476,681	16,984,644	5,654,792

Burimi: Raporti EITI i Perusë për vitet 2008-2010

Kutia 11 – Publikimi i transfertave diskrecionale në Peru (2005-2010) sipas rajoneve

(Programi i Minierave të Solidaritetit me Njerëzit – Shkurtimi në gjuhën spanjolle: PMSP – zbatuar nga viti 2005 deri në vitin 2010 dhe përfaqësuar nga një pjesë e rëndësishme e të ardhurave gjeneruar nga sektori i minierave në ato vite).

No.	Region	Committed		Executed		Progress level
		Amount S/.	%	Amount S/.	%	%
1.-	Ancash	482,520,072	40.62	423,638,588	48.52	88
2.-	Apurímac	714,781	0.06	706,951	0.08	99
3.-	Arequipa	269,985,570	22.73	96,984,235	11.11	36
4.-	Ayacucho	605,679	0.05	529,916	0.06	87
5.-	Cajamarca	177,937,227	14.98	151,630,278	17.37	85
6.-	Cusco	99,776,467	8.40	66,652,626	7.63	67
7.-	Huancavelica	1,663,561	0.14	1,494,679	0.17	90
8.-	Huánuco	34,997,187	2.95	30,672,012	3.51	88
9.-	Ica	8,938,645	0.74	7,134,630	0.82	80
10.-	Junín	4,533,771	0.38	4,834,247	0.55	107
11.-	La Libertad	16,836,566	1.42	16,459,985	1.87	98
12.-	Lambayeque	1,746,942	0.15	2,233,575	0.26	128
13.-	Lima	35,063,185	2.95	28,155,929	3.23	80
14.-	Lima (Callao)	966,555	0.08	832,530	0.10	86
15.-	Moquegua	4,223,693	0.36	4,101,017	0.47	97
16.-	Pasco	20,172,906	1.70	19,642,642	2.25	97
17.-	Puno	4,175,515	0.35	3,926,746	0.45	94
18.-	Tacna	22,871,065	1.93	13,413,185	1.54	59
19.-	No registrado	63,264	0.01	52,377	0.01	99
	Total	1,187,792,651	100	873,126,148	100	74%

Publikimi kompani për kompani

Meqenëse kjo i përket informimit të publikut, shihni adresën e mëposhtme për më shumë detaje

http://www.minem.gob.pe/minem/archivos/Informe036%20PMSP%20Agosto%202011.pdf

Ne ofrojmë informacion mbi shumat e Depozituara, të Angazhuara dhe të Ekzekutuara në terma globalë, kompani për kompani

Llojin e Fondeve, akumuluar në gusht 2011 (muaji i mbylljes së programi).

Meqenëse kjo i përket informimit të publikut, shihni adresën e mëposhtme për më shumë detaje

http://www.minem.gob.pe/minem/archivos/Informe036%20PMSP%20Agosto%202011.pdf

Për më shumë informacion, ju lutemi shihni:

- http://eiti.org/document/implementing-eiti-impact-handbook-policy-makers-and-stakeholders
- http://www.revenuewatch.org/publications/fact_sheets/subnational-oil-gas-and-mineral-revenue-management
- http://eiti.org/files/SWG/World_Bank_SWG_Paper_Note_on_EITI_reporting_by_subnational_governments_ April_2012.pdf
- http://www.eiwatch.org/2013/09/endorsing-the-sub-national-eiti-principles-to-the-region/
- http://www.odi.org.uk/publications/5021-sub-national-implementation-extractive-industries-transparency-initiative-eiti
- http://commdev.org/enhancing-local-benefits-taking-eiti-sub-national-level
- https://login.mailingëork.de/public/a_1593_d1CËj/file/data/2332_giz_en_2012_04_eiti_subnational_pdf

Udhëzimi 11 – dhjetor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org

Udhëzimi 11: Adresimi i çështjes së konfidencialitetit të taksapaguesit në raportimin e EITI-it

Përmbledhje

Subjektet qeveritare që marrin pjesë në EITI mund të jenë të kufizuara për sa i përket bërjes publike të informacionit mbi taksapaguesit, për shkak të dispozitave kushtetuese apo ligjore për konfidencialitetin dhe privatësinë e taksapaguesit. Ky udhëzues tregon mundësitë e trajtimit të kësaj çështjeje, duke u bazuar në përvojën e vendeve zbatuese të EITI-it.

Informacion sqarues

EITI u kërkon agjencive qeveritare të paraqesin një deklaratë gjithëpërfshirëse të të ardhurave nga taksat e industrive nxjerrëse. Të gjithë subjektet qeveritare që kanë të ardhura të mëdha duhet t'i bëjnë publike sipas qëllimit për të cilin është rënë dakort (Kërkesa 4.2a).

Subjektet qeveritare që marrin pjesë në EITI mund të kenë kufizime për sa i përket nxjerrjes së informacionit mbi taksapaguesit për shkak të ruajtjes së sekretit dhe ligjeve mbi privatësinë e taksapaguesit. Ligjet për ruajtjen e sekretit dhe privatësisë së taksapaguesit parashikojnë që informacioni në lidhje me taksapaguesin të jetë konfidencial dhe mund të përdoret vetëm nga autoriteti për të administruar sistemin e tatimeve, përveç se në rastet kur parashikohet ndryshe me ligj.

Në disa raste, qeveria mund të ketë lidhur kontrata me kompani nafte, gazi apo minierash, të cilat ndalojnë bërjen publike të ndonjë informacioni të rëndësishëm për tregtinë.

Udhëzim

Nuk ka një mënyrë të vetme – vendet e ndryshme kanë kuadër ligjor të ndryshëm dhe marrëveshje të tjera që mund të ndikojnë zbatimin, dhe do duhet që të përgjigjen në mënyra të ndryshme. Në rastet kur kontaktet ndalojnë nxjerrjen e informacionit në lidhje me pagesën e taksave, palët kontraktuese mund të jenë në gjendje, me një marrëveshje të dyanshme, që të ndryshojnë kontratën për të përfshirë edhe bërjen publike të pagesës së taksave, ose të gjejnë mënyra të tjera si ta bëjnë publik këtë informacion për qëllim të procesit të EITI-it.

Rekomandohet që Grupi Ndërinstitucional të shqyrtojë kuadrin ligjor dhe rregullator për të përcaktuar pengesat specifike që mund të ndikojnë zbatimin e EITI-it, si dhe të eksplorojnë mundësitë e ndryshme për të zgjidhur këto probleme.

Në disa vende zbatuese, autoritetet tatimore mund të nxjerrin informacion në disa rrethana specifike. Këtu mund të përfshihen kompetenca diskrete që i nënshtrohen testit të "interesit publik" dhe testeve të ngjashme. Grupi Ndërinstitucional duhet të angazhohet direkt me këto agjenci për të eksploruar mundësi në mënyrë që të përfitojë të dhënat e nevojshme. Grupi Ndërinstitucional duhet të dokumentojë mundësitë e shqyrtuara dhe përqasjen për të cilën është rënë dakort që të përdoret për të zgjidhur këtë problem.

Në bazë të eksperiencës së vendeve zbatuese të EITI-it, sugjerohet që në vlerësim të merren parasysh mundësitë e mëposhtme:

1. Miratimi apo ndryshimi i legjislacionit dhe rregulloreve

Shumë vende zbatuese kanë përdorur urdhrat ekzekutive, dekrete presidenciale, ministrore apo të ngjashme për të mandatuar bërjen publike, në masën e nevojshme për të plotësuar kriteret e EITI-it. Të tjerë kanë miratuar apo ndryshuar legjislacionin dhe rregulloret, për shembull, duke specifikuar pjesëmarrjen në EITI si një përjashtim nga dispozitat e zakonshme për ruajtjen e sekretit dhe privatësisë së taksapaguesit. Kjo ka rezultuar të jetë një përqasje efektive, edhe pse procesi legjislativ mund të kërkojë kohë dhe mund të vonojë ndjeshëm zbatimin e EITI-it .

2. Aksesi përmes ndërmjetësve/palëve të treta

Të dhënat e nevojshme mund të merren edhe përmes ndërmjetësve/palëve të treta. Një agjenci qeveritare statistikash, auditori i përgjithshëm, një komision parlamentar, avokati i popullit, apo një organi të ngjashëm mund t'i jepet autoriteti për të kërkuar të dhënat e nevojshme dhe për t'ia vënë në dispozicion Administratorit të Pavarur (si dhe publikut) me fleksibilitet më të madh se autoriteti tatimor. Për shembull, Administratori i Pavarur mund të kontraktohet nga agjencia qeveritare e statistikave apo nga auditori i përgjithshëm dhe i jepet mundësia të përdorë aksesin që kjo agjenci ka në të dhënat.

3. Salla e të dhënave

Agjencitë qeveritare mund të përdorin "sallën e të dhënave" (ose sallën virtuale të të dhënave) për qëllime të procesit të EITI-it. Sallat e të dhënave përdoren shpesh nga agjencitë qeveritare për të nxjerrë një vëllim të madh të dhënash konfidenciale. Një sallë tradicionale të dhënash është një dhomë fizike e sigurt (zakonisht ndodhet në zyrën e organizatës që nxjerr të dhënat), ku mund të shkojnë palët e autorizuara (si p.sh. Administratori i Pavarur i EITI-it) për të inspektuar dhe raportuar mbi dokumente të ndryshme dhe të dhëna të tjera. Një sallë virtuale të dhënash përfshin të njëjtën procedurë, përmes një portali të sigurt *online*. Administratori i Pavarur i EITI-it duhet të respektojë dispozitat e ruajtjes së sekretit dhe është i kufizuar në mundësinë për t'u dhënë palëve të treta informacion të detajuar duke ia transferuar, kopjuar apo printuar. Mund të nevojitet edhe një auditim i detajuar për arsye ligjore (d.m.th. një historik i 'kush ka parë cilin version të secilit dokument').

4. Heqja dorë e taksapaguesit

Në disa raste, taksapaguesi mund të zgjedhë të heqë dorë nga e drejta për ruajtje të sekretit dhe privatësisë. Shumë prej vendeve zbatuese i kanë kërkuar secilës kompani që t'iu kërkojë autoriteteve tatimore t'ia bëjnë të ditur të dhënat e tyre Administratorit të Pavarur. Në rastet kur kjo mundësi ekzistonte, ka rezultuar i dobishëm krijimi i një letre shabllon me gjuhë të standardizuar për këtë qëllim.

5. "Zgjidhja alternative" ndaj heqjes dorë nga taksapaguesi

Në disa vende, autoritetet tatimore mund të mos lejohen t'i japin të dhëna Administratorit të Pavarur, edhe nëse autoritetet tatimore e kanë autorizuar agjencinë për këtë veprim, për shkak të kufizimeve kushtetuese dhe/ose legjislative. Në këto raste, është përdorur një "zgjidhje alternative" ku taksapaguesi i kërkon agjencisë një kopje të të dhënave të veta, të cilën më pas ia jep Administratorit të Pavarur. Kjo përqasje bazohet mbi faktin që taksapaguesi ka të drejtën të marrë një kopje të të dhënave të veta. Për ta mbrojtur procedurën e rakordimit, procesi mund të ndahet në hapa, në mënyrë të tillë që kompanitë t'i japin të dhënat e tyre Administratorit të Pavarur përpara se të kërkojnë të dhënat nga qeveria. Nevojitet edhe një procedurë që verifikon se të dhënat qeveritare nuk janë ndryshuar. Projekti pilot EITI në Australi përdor një shkëmbim elektronik të dhënash duke përdorur dosje të mbrojtura me fjalëkalim.

Rast studimor – Peru

Kushtetuta e Perusë (Neni 2(5)) parasheh të drejtën e qytetarëve për të marrë informacion nga subjektet publike. Kjo reflektohet në Ligjin e Transparencës Nr. 27806. Megjithatë, mandati kushtetues parashikon një përjashtim sa i përket informacionit mbi taksat, Neni 85 i Kodit Tatimor (Dekreti Suprem Nr. 135-99-EF)[7]. Sipas tij, "shuma dhe burimi i të ardhurave, shpenzimeve, të taksueshmeve apo të dhëna të tjera" në lidhje me taksapaguesin, janë konfidenciale dhe nuk mund të bëhen publike përveçse për disa qëllime të caktuara (asnjë prej tyre nuk i përket EITI-it).

Kjo e bënte të vështirë marrjen e të dhënave qeveritare për taksën mbi të ardhurat të paguar nga kompanitë e naftës, gazit dhe minierave. Këto përbënin 74% të të ardhurave totale të qeverisë në Raportin e EITI-it 2010. Burime të tjera të ardhurash si renta minerare dhe të drejtat e vlefshmërisë konsiderohen si pagesa jo-fiskale (*pagos no-tributarios*) dhe, si pasojë, nuk u hasën pengesa për nxjerrjen dhe rakordimin e këtyre shifrave.

Për të trajtuar këtë çështje, Grupi Ndërinstitucional i Perusë hartoi një procedurë vullnetare ku kompanitë hiqnin dorë nga e drejta e tyre e ruajtjes së sekretit të informacionit. Në bazë të të dhënave mbi prodhimin, 50 kompani u identifikuan si të mëdha dhe do të përfshiheshin në Raportin e EITI-it. U shpenzua shumë kohë për të kontaktuar këto kompani dhe për t'i shpjeguar procesin EITI. Kompanitë e përzgjedhura u ftuan që të nënshkruanin një formular ligjor detyrues ku ato:

[7] Mund të gjendet në këtë link (i përkthyer në anglisht)
http://www.microsofttranslator.com/bv.aspx?from=&to=en&a=http://www.sunat.gob.pe/legislacion/codigo/libro2/titulo3.htm

1. Angazhoheshin për të raportuar të ardhurat dhe pagesat përkatëse të taksave;
2. Hiqnin dorë nga e drejta e ruajtjes së sekretit dhe autorizonin agjencinë tatimore (SUNAT) për t'i bërë publike të ardhurat përkatëse; dhe
3. Zgjidhnin nëse bërja publike do të bëhej mbi një bazë agregimi apo jo agregimi.

33 kompani ranë dakort për të marrë pjesë në raportin e parë. Kjo shifër u rrit ndjeshëm në raportin e dytë dhe Peruja arriti Pajtueshmërinë [me kriterin], sepse tregoi që raportonte të gjitha pagesat dhe të ardhurat kryesore.

Udhëzimi 12 – dhjetor 2013

Ky udhëzim është nxjerrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-it për t'u ofruar orientime vendeve zbatuese për përmbushjen e kërkesave të standardit të EITI-it. Këshillohet që lexuesit t'i referohen direkt Standardit të EITI-it dhe të kontaktojnë Sekretariatin Teknik për të kërkuar sqarime të mëtejshme. Informacioni i kontaktit mund të gjendet në www.eiti.org

Udhëzimi Nr. 12: Raportet Përmbledhëse të EITI-it

Kërkesat 6.1.c, 6.2.a dhe 6.2.b

Raportet e EITI-it mund të jenë një burim i rëndësishëm informacioni rreth mënyrës se si menaxhohen pasuritë natyrore të një shteti. Sidoqoftë, tematika është shpesh e ndërlikuar dhe teknike, çka kthen në sfidë prezantimin e saj në një mënyrë të kuptueshme, sidomos për ata që nuk janë specialistë. Disa nga raportet e para të EITI-it treguan që ishin shumë të vështirë për tu kuptuar dhe përdorur nga qytetarët, gazetarët dhe palët e tjera. Në mënyrë që të merren përfitime nga EITI-it, dhe që të përmbushen kërkesat e Standardit të EITI-it, shtetet zbatuese këshillohen të përkushtojnë kohë dhe burime për t`u siguruar që Raportet e EITI-it të jenë të kuptueshme lehtë.

Standardi i EITI-it kërkon që raporti i EITI-it të jetë "i kuptueshëm, duke u siguruar që të shkruhet me stil të qartë dhe të aksesueshëm dhe duke përdorur një gjuhë të përshtatshme" (6.1.c). Raporti i EITI-it hartohet në shumicën e rasteve nga një Administrator i Pavarur. Kur autorësia e disa pjesëve në raport është e Grupit Ndërinstitucional, sekretariatit kombëtar apo e të tjerëve, kjo duhet të theksohet qartë në raport. Kur hartojnë Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur, Grupi Ndërinstitucional këshillohet të sigurojë që Raporti i EITI-it është i strukturuar mirë dhe përdor gjuhë të qartë dhe konçize. Nevojitet punë e mëtejshme për të siguruar që raporti të jetë i kuptueshëm lehtë.

Si masë për të përmirësuar më tej aksesibilitetin e Raporteve të EITI-it, Standardi i EITI-it nxit publikimin e një Raporti përmbledhës së EITI-it (6.2.a). Një raport përmbledhës ka disa përdorime:

- Si përmbledhje ekzekutive, duke shërbyer si parathënie e Raportit të plotë të EITI-it të hartuar nga Administratori i Pavarur.
- Shumë shtete kanë zgjedhur të zhvillojnë një raport përmbledhës së EITI-it që printohet dhe përdoret si një mjet kyç komunikimi.
- Shtetet që bëjnë raportim të EITI-it me anë të bazave online të të dhënave (siç përshkruhet në kërkesën 6.2.c) mund të zgjedhin të zhvillojnë vetëm një raport përmbledhës së EITI-it, dhe t'i vendosin të dhënat e hollësishme dhe teknike online.

Është e rëndësishme që raportet përmbledhëse të rishikohen dhe miratohen nga Grupi Ndërinstitucional, siç ndodh dhe me Raportet e plota të EITI-it. Prandaj, një praktikë e mirë është të sigurohet që të gjithë strukturat të konsultohen për përgatitjen e një

përmbledhjeje të tillë. Ky udhëzim ofron këshilla për sekretariatet kombëtare dhe Grupit Ndërinstitucional, dhe prezanton disa praktika të mira nga shtetet zbatuese. Udhëzuesi Komunikimit të EITI-it, *Talking Matters*[8] mund të konsultohet për këshilla të mëtejshme rreth zhvillimit të mesazhit, stilit dhe këshillave të të shkruarit dhe për udhëzime të tjera për hartimin e një Raporti përmbledhës së EITI-it.

Kërkesa 6

EITI kërkon që Raportet e EITI-it të jenë të kuptueshme, të promovohen në mënyrë aktive, të jenë të aksesueshme publikisht dhe të japin kontribut në debatin publik.

6.1 Grupit Ndërinstitucional i kërkohet të:

c) Sigurojë që Raporti i EITI-it është i kuptueshëm, duke u siguruar që të shkruhet me stil të qartë dhe të aksesueshëm dhe duke përdorur një gjuhë të përshtatshme.

6.2 Grupi Ndërinstitucional nxitet të:

a) Hartojë raporte përmbledhëse të shkurtra, me analizë të qartë dhe të ekuilibruar të informacionit, duke siguruar që autorësia e elementëve të ndryshëm të Raportit të EITI-it të theksohet qartë.

b) Përmbledhë dhe të krahasojë raportin e secilit burim të ardhurash ndaj shumës totale të të ardhurave që vilet nga secili nivel përkatës i qeverisjes.

Burimi: Standardi i EITI-it (11 Qershor 2013), faqe 32-33

Më shumë se sa një përmbledhje: një mjet qendror për të informuar dhe ndikuar diskutimet e publikut.

Një përmbledhje e Raportit të EITI-it zakonisht përfshin një panoramë të shkurtër të qeverisjes së sektorit të industrisë nxjerrëse, informacione financiare kyçe rreth pagesave të bëra nga kompanitë dhe pagesave të marra nga qeveria, një shpjegim i shkurtër rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të bëra nga Administratori i Pavarur.

Një përmbledhje, zakonisht jep informacionin kryesor të një dokumenti në një hapësirë prej 10% të gjatësisë së raportit origjinal[9]. Raporti përmbledhës:

- mund të pritet të tërheqë më shumë lexues se sa raporti i plotë;
- do të shërbeje si mjeti qendror për të informuar dhe ndikuar debatin publik rreth gjendjes së transparencës së pasurive natyrore në vend;
- do të jetë mjeti kryesor i sekretariatit dhe Grupit Ndërinstitucional për të artikuluar ato që shohin si gjetje kyç për të cilat është rënë dakord dhe për të rekomanduar veprime të mëtejshme; dhe
- mund të jetë një mundësi për të angazhuar lexuesin drejt veprimeve të mëtejshme.

[8] http://EITI NTIN.org/document/talking-matters
[9] Talking Matters, f. 63

Për këtë arsye, sekretariati kombëtar dhe Grupi Ndërinstitucional këshillohen të kujdesen për të zhvilluar mesazhe kyçe[10] brenda raporteve përmbledhëse. Këto mesazhe artikulojnë atë çfarë duan Grupet Ndërinstitucionale që publiku i synuar[11] të kuptojë.

Një qasje e mirë është të marrësh parasysh sikur lexuesi i raportit përmbledhës ka pak apo aspak njohuri rreth EITI-it. Prandaj është e rëndësishme të jepet informacion kontekstual rreth EITI-it kombëtar dhe të kufizohet përdorimi i shprehive teknike në raportin përmbledhës.

Lista e kontrollit

Mund të jetë i dobishëm përdorimi i listës së kontrollit si më poshtë gjatë hartimit të Raportit përmbledhës së EITI-it:

- A jep një panoramë konçize të sektorit nxjerrës të vendit, të pagesave të kompanive dhe të ardhurave të qeverisë?
- A identifikon përmbledhja gjetjet dhe rekomandimet kyçe të raportit?
- A përmban një kombinim të shpjegimeve dhe pamjeve si grafikë, grafikë informues, figura, etj.?
- A është rishikuar nga ndonjë person që nuk ka informacion rreth EITI-it dhe, me aq sa është e mundur, a i janë hequr shprehjet teknike që nuk kuptohen gjerësisht?
- A shpjegon shkurtimisht se çfarë është EITI dhe qëllimin e Standardit të EITI-it, dhe a tregon ku mund të gjendet një informacion i mëtejshëm?
- A shpjegon se si të gjendet pjesa tjetër e raportit EITI-it ?
- A shpjegon qartësisht nëse ka ndonjë mospërputhje të pazgjidhur?
- A shpjegon me terma jo teknikë apo tregon me pamje: burimet e të ardhurave që mbulohen, raportin e secilit burim të ardhurash ndaj shumës totale të të ardhurave, dhe pjesën që shkon për nivelet respektive të qeverisjes?
- A është e qartë kush e ka shkruar raportin përmbledhës?
- Mund të merret parasysh citimi i ndonjë ministri apo i ndonjë zyrtari të qeverisë, për shembull një mbështetësi të EITI-it apo Kryetarit të Grupit Ndërinstitucional.
- A tregon përmbledhja se ku raporti shkon përtej kërkesave minimale të Standardit të EITI-it me një shpjegim se cilat elemente janë përfshirë dhe përse?
- A tregon përmbledhja se ku mund të gjendet informacion i mëtejshëm: informacion për kontakte, një faqe interneti, ndonjë referencë për ndonjë raport plotësues apo informacione të tjerë të rëndësishme?

[10] Zhvillimi i mesazhit, shih Talking Matters, f. 28-35
[11] Publiku i synuar, shih Talking Matters, f. 23

Praktikat e mira

Praktika e mirë 1: Tekst i shkurtër dhe gjuhë e thjeshtë për të pasur një përmbledhje konkrete

Tanzania[12] ka hartuar një raport përmbledhës për Raportin e dytë EITI , i cili mbulonte vitin fiskal 2010. Kjo përmbledhje paraqiste një pjesë hyrëse shpjeguese rreth EITI-it dhe rreth rëndësisë së transparencës dhe një përshkrim të të dhënave që ishin bashkërenduar.

Praktika e mirë 2: Vizualizo informacionin duke përdorur grafikë

Raporti i vitit 2011 i Azerbajxhanit përdor vizualizime për të shpjeguar gjetjet e Raportit të EITI-it dhe të dhënat që kanë të bëjnë me menaxhimin e sektorit të pasurive natyrore. Grafiku më poshtë tregon marrëdhënien ndërmjet transfertave të bëra nga Fondi i Naftës dhe të ardhurat e buxhetit kombëtar dhe shpenzimet.

Burimi: Raporti i vitit 2011 i Azerbajxhanit, faqe 11[13]

Praktika e mirë 3: Kontekstualizimi i informacionit financiar

Raporti i EITI-it i Nigerisë për periudhën 2009-2011[14] jep një tabelë përmbledhëse të vlerave financiare të marra nga qeveria, ndërmjet viteve 2009 dhe 2011, të detajuara sipas kategorisë së taksës. Kjo tabelë ndiqet nga një koment shpjegues që bën një analizë të flukseve financiare.

"1.5.1 Analiza e Flukseve Financiare

Flukset financiare totale për Federatën dhe për subjektet e tjera të qeverisë gjatë viteve 2009-2011 nën studim janë në shifrën 143.5 miliard USD, (me një rënie prej 4% ndaj periudhës 2006-2008 ku totali ishte 148.8 miliard USD). Kjo rënie vjen kryesisht prej një zvogëlimi prej 50% (nga 60 miliard USD në 30 miliard USD) në vitin 2009 si pasojë e rënies së çmimit të naftës (nga 100 USD për fuçi në vitin 2008 në 63

[12] Shih Talking Matters, faqe 64
[13] http://NTIN.org/files/Azerbaijan-2011-NTIN-Report.pdf
[14] http://NTIN.org/files/NNTIN-NTIN-Core-Audit-Report-Oil-Gas-2009-2011-310113-New_4.pdf

USD për fuçi në vitin 2009) pavarësisht volumeve të prodhimit që ishin mjaft konsistentë. Rritja e mesatares së çmimit të naftës në vitin 2010 dhe 2011 (nga 80 USD në 112 USD për fuçi) çoi në rritje të flukseve financiare gjatë viteve të mëvonshme me një fluks total prej 68 miliard USD në vitin 2011."

Burimi: Faqe 5, Raporti i EITI-it i Nigerisë për periudhën 2009-2011

Praktika e mirë 4: Vizualizimi me figura dhe procesi i rakordimit

Përmbledhja e Raporti i EITI-it i Norvegjisë për vitin 2011 përfshin një shpjegim të shkurtër të procesit të rakordimit me anë të mjeteve vizuale. Me pak rreshta dhe në një mënyrë shumë ndërvepruese, teksti përmbledhës tregon numrin e kompanive që kanë raportuar brenda afatit të caktuar në Ligjin Norvegjez për EITI-in, nivelin e mospërputhjeve, nëse mospërputhjet ishin zgjidhur dhe kontekstualizonte flukset financiare.

(Figura me titull 'Executive Summary' ne faqen 5 te kësaj pjese)

Burimi: faqe 4, përmbledhja ekzekutive e Raporti i EITI-it i Norvegjisë për vitin 2011